



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9 regjistri (JR)  
Datë 12.02.2019

Nr. 3 i vendimit  
Datë 04.03.2020

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Luan Daci</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 04.03.2020, ditën e mërkurë, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elda Faruku, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 9, datë 12.02.2019, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Izet Kadana, gjyqtar, dhe me funksion kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 92, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 92, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Izet Kadana, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe njëkohësisht edhe të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, duke u shortuar më datë 15.03.2018.

2. Bazuar në përcaktimet e neneve 31 – 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”). Konkretisht:

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenet 30 – 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar<sup>1</sup>, duke konstatuar se:

- i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të figurës, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të siguruara nga autoritetet verifikuese, bazuar në përcaktimet e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e rishikuar të figurës, duke konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.<sup>2</sup>

2.3. KLD-ja, pasi ka analizuar aftësitë profesionale bazuar në formularin e vetëdeklarimit, në tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe në të dhënat e dokumenteve që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, në pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në të dhënat nga burimet arkivore, ka dërguar një raport të arsyetuar.<sup>3</sup>

3. Bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi të kryejë procesin e rivlerësimit për këtë subjekt për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Me vendimin nr. 92, datë 20.12.2018, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Vendimi u mor bazuar në nenin 61, pikat 2, 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, pasi Komisionit, për secilin kriter vlerësimi respektivisht, i ka rezultuar se:

4.1. *lidhur me kriterin e pasurisë*, subjekti i rivlerësimit:

- ka kryer deklarime të pasakta lidhur me burimin e të ardhurave për dhënien e dy huave, sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016;

<sup>1</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 18.01.2018.

<sup>2</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 09.11.2018.

<sup>3</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 17.07.2017.

- ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar likuiditetin në shumën prej 1.186.981 lekësh, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016;
- ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, sipas nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016;

4.2. *lidhur me kriterin e figurës*, subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës sipas nenit Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016;

4.3. *lidhur me kriterin e aftësive profesionale*, subjekti i rivlerësimit edhe pse ka arritur nivel kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, aftësive organizative, aftësive personale dhe angazhimin profesional, ka cenuar etikën gjatë komunikimit me shtetasen F.L. (një nga kriteret e vlerësimit profesional sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”), si dhe qëndrimet dhe ndikimi i tij në lidhje me emërimin në detyrë të bashkëshortes, znj. S.K., në pozicionin e kryesekretares/ekonomistes në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë, të provuara gjatë procesit të rivlerësimit, ndikojnë drejtpërdrejt në cenimin e besimit të publikut te subjekti i rivlerësimit, si pjesë e sistemit të drejtësisë. Sipas nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, për sjellje të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

5. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit:
- nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016;
  - nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e kontrollit të figurës sipas përcaktimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016;
  - ka reflektuar sjellje të papërshtatshme për pozicionin e tij si gjyqtar, duke cenuar etikën e gjyqtarit sipas përcaktimeve të nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, kreut VI të ligjit nr. 84/2016 dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016;
  - në vlerësim të përgjithshëm të të gjitha rrethanave, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

### III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim më datë 01.02.2019 kundër vendimit të Komisionit që vendosi sa më sipër. Ankimi, i cili u pranua nga Komisioni me vendimin nr. 92/1, datë 04.02.2019, bazohet në nenet 63 dhe 66, pika 1 shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 46 të ligjit nr. 49/2012. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.
7. Shkaqet e ankimit lidhen kryesisht me çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale, procesit të rregullt ligjor, si dhe me vlerësimin që ka kryer Komisioni për secilin kriter të procesit të rivlerësimit.
8. Shkaqet e ankimit që lidhen kryesisht me çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale dhe procesit të rregullt ligjor në mënyrë të përmbledhur janë si vijojnë.
- i) Vendimi është marrë në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në mungesë koherence me provat e administruara, pasi:
    - a) është në kundërshtim me nenet 30, 31, 32, 34, 35, 38, 43, 44 dhe 61, pikat 2, 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016;

- b) është në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 96/2016 dhe Komisioni i ka atribuar vetes kompetenca që u përkasin organeve të tjera, lidhur me vlerësimin e cenimit të figurës dhe etikës së magjistratit;
- c) është marrë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës dhe nenet 6, 7, 8, 13 e 14, si dhe protokollet përkatëse shtesë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”), duke shkelur në mënyrë të hapur dhe të përsëritur parimet dhe të drejtat e njeriut.
- ii) Komisioni ka vendosur që në fillim shkarkimin e tij nga detyra duke kryer një proces hetimi dhe gjykimi administrativ formal, të pabazuar në provat dhe shpjegimet e paraqitura.
- iii) Komisioni ka lejuar shkelje procedurale, pasi vëzhguesi ndërkombëtar ka komentuar veprimet e subjektit të rivlerësimit, komente që kanë ndikuar në paracaktimin e vendimit.
- iv) Komisioni ka qenë i njëanshëm, jo i pavarur, tendencioz, i ndikuar nga faktorë jashtë procesit dhe ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, duke filluar me paragjykim dhe përfunduar me vendim të paracaktuar.
- v) Komisioni nuk e ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues Xhensila Pine, pavarësisht se ai ka pasur dyshime për njëanshmëri të saj, e vërtetuar edhe me vendimin e dhënë.
9. Shkaqet e ankimit që lidhen me themelin e gjykimit për secilin kriter të rivlerësimit përmbledhen si në vijim, sipas kriterëve.

#### 9.1. Lidhur me procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë:

i) përfundimi i Komisionit se ka kryer deklarime të pasakta lidhur me burimin e të ardhurave për dhënien e dy huave<sup>4</sup>, është i gabuar pasi:

a) subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursente ndër vite dhe, për rrjedhojë, huaja e dhënë z. M.M. në shumën 7.000.000 lekë, më datë 03.04.2014, nuk është në kushtet e burimeve të paligjshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013 [të dorëzuar më 25.03.2014] është deklaruar gjendje *cash* në shumën 7.474.331 lekë<sup>5</sup>, nga kursimet ndër vite. Në këtë mënyrë, justifikohen shuma prej 314.643 lekësh, për vitin 2003, që është rrjedhojë e kursimeve para vitit 2003, shuma prej 139.086 lekësh në vitet 2005 – 2006 që është një gabim i kryer nga punonjësja e bankës dhe shuma prej 699.231 lekësh për vitin 2008, që ka qenë një kredi e marrë nga bashkëshortja për babanë e saj, në vlerën 700.000 lekë;

b) kredia në vitin 2007 është marrë nga bashkëshortja për babanë e saj dhe konsiderimi i deklaratave noteriale të dy të afërmve [nëna dhe vëllai i bashkëshortes] si akte deklarative të njëanshme është një vlerësim joetik, jokorrekt dhe joprofesional nga ana e Komisionit. Për më tepër, që ai [subjekti i rivlerësimit] ka kërkuar që në rast të pamjaftueshmërisë së këtyre deklaratave, deklaruesit të pyeteshin si dëshmitarë;

c) huaja e dhënë z. A.P. më datë 20.02.2015, në shumën 1.400.000 lekë, është mbuluar nga të ardhura të ligjshme, duke mbajtur në konsideratë shpjegimet e dhëna për të ardhurat e gjeneruara gjatë viteve 2003, 2004, 2005 – 2006 dhe 2008. Kështu në deklaratën e interesave

<sup>4</sup> Shih faqen 22 të vendimit të Komisionit.

<sup>5</sup> Konstatohet mospërputhje të dhënash në ankim, me gjasë gabime materiale. Konkretisht, subjekti i referohet deklaratës së interesave periodikë të vitit 2014, ndërkohë, sipas deklaratës së interesave privatë periodikë, pasuria e mbetur gjendje “cash” në vlerën 7.474.331 lekë, për dhënien e huas z. M.M., në vlerën 7.000.000 lekë, i përket vitit 2013. Po aty, edhe shuma e deklaruar në atë deklaratë periodike vjetore, në rubrikën “Ndryshimet e pasurisë dhe burimi i krijimit”, si vlerë e mbetur gjendje “cash”, është 7.474.331 lekë dhe jo 747.331 lekë, sikurse është shprehur subjekti i rivlerësimit në ankim.

privatë për vitin 2014 [dorëzuar më datë 30.03.2015], ka deklaruar gjendjen cash në vlerën 1374.331 lekë, për rrjedhojë ai ka pasur mundësi reale për ta dhënë huan;

ii) përfundimi i Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar likuiditetin në vlerën 1186981 lekë (për periudhën 2003 – 2016)<sup>6</sup>, është i gabuar. Sipas tij, kjo është një pasuri e ligjshme që rrjedh nga puna e tij dhe e bashkëshortes, duke filluar nga viti 1994. Në ankim subjekti i rivlerësimit analizon gjendjen e tij financiare për vitet 2003, 2004, 2005 dhe 2006, 2008, 2014 dhe 2015, ndërsa për vitet 2007, 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013 parashtron se sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, ka pasur të ardhura të mjaftueshme.

iii) konstatimi i Komisionit për gjendjen e konfliktit të interesit<sup>7</sup> në rastin e gjykimit të çështjes me palë ndërgjyqëse z. A.P., ku është vendosur pushimi i çështjes, është i gabuar. Marrëdhënia shoqërore në vitin 2013, gjatë procesit gjyqësor, nuk ka qenë e njëjtë me atë të vitit 2015, kur u krijua edhe raporti kredi/debi ndërmjet tyre. Komisioni ngatërron konceptin e “pushimit të gjykimit të një çështjeje” me “pushimin e çështjes”, “vendim i ndërmjetëm” me “vendim jopërfundimtar” apo “vendim përfundimtar”.

**9.2.** Lidhur me procesin e rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit, sipas të cilit takimet me vëllanë R.K. përbëjnë kontakt të papërshtatshëm dhe që subjekti mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale, pasi:

a) takimet me vëllanë janë kryer vetëm në raste fatkeqësie dhe raste përkujtimore dhe për këtë çështje ai ka dhënë të gjitha informacionet e nevojshme;

b) raporti i DSIK-së është i pasaktë, i pabazuar, në kundërshtim me ligjin, i diktuar nga Komisioni dhe i pabazuar, pasi vepra penale e falsifikimit, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, nuk përfshihet në veprat penale të krimit të organizuar;

c) vetëm pas hetimit të Komisionit ka mësuar se disa nga nipërit kanë pasur probleme me drejtësinë, për vepra penale që nuk lidhen me krimin e organizuar. Djali i tij ka qenë te banesa e vëllait R.K. vetëm për të shoqëruar bashkëshorten e vëllait për të ndjekur trajtimin mjekësor;

ç) ka rreth 25 vite i ndarë nga vëllai dhe kontaktet e subjektit me të dhe nipërit janë të rralla. Nuk ka prova se këta persona mund të ndikojnë apo të ushtrojnë presion mbi veprimtarinë e tij profesionale.

**9.3.** Lidhur me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit parashtron se sipas raportit të KLD-së, datë 17.07.2018, është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, dhe për aftësitë personale dhe angazhimin profesional. Të gjitha vendimet objekt hetimi kanë marrë formë të prerë ose janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit apo Gjykata e Lartë. Sa i përket komunikimit me znj. F.L., subjekti i rivlerësimit parashtron se ka pranuar që ka qenë një gabim i tij e që nuk lidhet me detyrën. Ndikimi i tij për punësimin e bashkëshortes është një hamendësim i Komisionit, duke qenë se nuk ka asnjë njohje, lidhje apo komunikim me personat që kanë vendosur emërimin.

**10.** Më datë 10.01.2020, tri (3) ditë përpara seancës së njoftuar dhe të caktuar në dhomë këshillimi, më 13.01.2020, është regjistruar kërkesa e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues, z. Luan Daci, të caktuar me short, në

<sup>6</sup> Shih faqen 21 të vendimit të Komisionit.

<sup>7</sup> Shih faqen 18 të vendimit të Komisionit.

shkurt të vitit paraardhës [shorti i datës 18.02.2019]. Në kërkesën e tij, subjekti i rivlerësimit parashtroi se gjyqtari në fjalë gjendet në kushtet e ndalimit, të parashikuara nga neni 6, pika 1, germat “b” dhe “dh” të ligjit nr. 84/2016.<sup>8</sup>

11. Më datë 21.01.2020, është regjistruar kërkesa e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e gjyqtares Natasha Mulaj, po ashtu anëtare e trupit gjykues të ngarkuar me shqyrtimin e ankimit. Në kërkesë, subjekti i rivlerësimit parashtroi se përbërja e trupit gjykues është në kundërshtim me garancitë për gjykimin nga një gjykatë e paanshme dhe se bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, nenin 30, germa “dh” e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, znj. Natasha Mulaj duhet të kishte hequr dorë nga shqyrtimi i ankimit të tij.<sup>9</sup>

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

###### I) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimit të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Izet Kadana. Ankimet ndaj vendimeve të Komisionit në Kolegji shqyrtohen sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### II) Legjitimimi i ankuesit

13. Ankuesi, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, duke qenë subjekt rivlerësimi. Ankuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016<sup>10</sup>.

###### III) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në zbatim të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 92, datë 20.12.2018, u bë në bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Trupi gjykues vuri re se nuk gjente zbatim asnjë nga rrethanat e përcaktuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, që do të krijonte nevojën e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve apo të krijonte nevojën e debatit gjyqësor, pasi nuk nevojitej vërtetimi i fakteve apo marrja e provave të reja, nuk u konstatuan shkelje procedurale dhe nuk nevojitej përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha

<sup>8</sup> Kërkesa e protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., datë 10.01.2020, shoqërohet nga: i) jetëshkrimi i anëtarit të Kolegjit, z. Luan Daci; ii) procesverbali i mbledhjes së Kuvendit [faqe 50-53]; dhe iii) procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 18.11.2016.

<sup>9</sup> Kërkesa e protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., mban datën 20.01.2020 dhe shoqërohet nga: i) fotokopje e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2004, të Gjykatës së Rrethit Tropojë, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen (të njësuar nga noteri më datë 14.01.2020); dhe ii) fotokopje të përgjigjes së gjyqtares Natasha Mulaj me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.11.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit F.H. (të njësuar nga noteri më datë 20.01.2020).

<sup>10</sup> Vendimi i Komisionit i është njoftuar subjektit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 17.01.2019, dhe është marrë në dorëzim prej tij më datë 18.01.2019. Më datë 01.02.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankimin pranë Komisionit. Ankimi është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 92/1, datë 04.02.2019, që i është komunikuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.02.2019.

provave të marra nga Komisioni<sup>11</sup>. Nga materialet e administruara në fashikull, rezultuan të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kërkuar në ankim shqyrtimin në seancë gjyqësore publike.

15. Më datë 10.01.2020, pas më shumë se dy javësh nga njoftimi dhe shpallja më 12.12.2019 e datës së zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi<sup>12</sup>, subjekti i rivlerësimit kërkoi përjashtimin e anëtarit të trupit gjykues, z. Luan Daci, nga gjykimi i çështjes që i përket ankimit të tij kundër vendimit të Komisionit<sup>13</sup>.
16. Më datë 13.01.2020, trupi gjykues i Kolegjit, pasi u njoh me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, vendosi pezullimin e shqyrtimit gjyqësor të çështjes deri në shqyrtimin e kërkesës nga një tjetër trup gjykues<sup>14</sup>, me qëllim garantimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave themelore të subjektit të rivlerësimit, që lidhen me zhvillimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.
17. Me vendimin nr. 9/5, datë 22.01.2020, trupi gjykues i shortuar<sup>15</sup> për të shqyrtuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit të shtjelluar në paragrafët 10 dhe 15 vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, pasi konstatoi se nuk ekzistonte asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk u vërtetuan pengesat ligjore apo rastet e konfliktit të interesit të parashikuara nga neni 27 i ligjit nr. 84/2016, neni 30 i Kodit të Procedurave Administrative, ose nga ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9367/2005”), që do të bënin të nevojshëm përjashtimin e gjyqtarit Luan Daci nga trupi gjykues që do të shqyrtonte ankimin e subjektit të rivlerësimit.
18. Më datë 21.01.2020, është regjistruar kërkesa<sup>16</sup> e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e gjyqtarës Natasha Mulaj nga gjykimi i çështjes që i përket ankimit të tij kundër vendimit nr. 92, datë 20.12.2018, të Komisionit. Me vendimin nr. 9/7, datë 24.01.2020, trupi gjykues i Kolegjit<sup>17</sup>, i zgjedhur me shortin e datës 21.01.2020, vendosi mospranimin e kësaj kërkesë, pasi rezultoi se ishte paraqitur jashtë afatit 3-ditor të përcaktuar në nenin 74 të Kodit të Procedurës Civile.
19. Më datë 23.01.2020, gjyqtarja Natasha Mulaj paraqiti kërkesën për heqjen dorë<sup>18</sup> nga pjesëmarrja në cilësinë e anëtares së trupit gjykues për shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit nr. 92, datë 20.12.2018, të Komisionit. Me vendimin nr. 9/8,

---

<sup>11</sup> Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 parashikon: “[...] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë [...]”.

<sup>12</sup> Njoftimi për datën e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi në Kolegj, iu komunikua subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.12.2019, dhe në rrugë elektronike më datë 13.12.2019 (konfirmuar në rrugë elektronike marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 16.12.2019).

<sup>13</sup> Regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot.

<sup>14</sup> Njoftuar në faqen zyrtare të Kolegjit: <http://kpa.al/njoftim-246/>.

<sup>15</sup> Trupi gjykues i Kolegjit i shortuar për këtë qëllim përbëhej nga gjyqtarët: Ardian Hajdari – kryesues; Ina Rama, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz dhe Sokol Çomo – anëtarë.

<sup>16</sup> Regjistruar me nr. {\*\*\*} prot., në Kolegj.

<sup>17</sup> Trupi gjykues i Kolegjit i shortuar për këtë qëllim përbëhej nga gjyqtarët: Albana Shtylla – kryesuese, Ardian Hajdari, Luan Daci, Rezarta Schuetz dhe Sokol Çomo – anëtarë.

<sup>18</sup> Regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot.

datë 04.02.2020, trupi gjykues i Kolegjit<sup>19</sup>, i zgjedhur me shortin e datës 23.01.2020, vendosi pranimin e kërkesës së gjyqtarës Natasha Mulaj për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes nr. 9/2019 (JR), datë 12.02.2019, bazuar në përcaktimet e nenit 30, germa “g” e Kodit të Procedurës Administrative dhe të nenit 72, paragrafi 6 i Kodit të Procedurës Civile. Më tej, me shortin e datës 05.02.2020, gjyqtarja Natasha Mulaj u zëvendësua nga gjyqtari Ardian Hajdari<sup>20</sup>.

20. Trupi gjykues i Kolegjit, gjatë shqyrtimit të vendimit nr. 92, datë 20.12.2018, konstatoi se në bazën ligjore të arsyetimit përfundimtar të vendimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i është referuar nenit 58, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, që parashikon *konfirmimin* në detyrë, ndërkohë që shkarkimi nga detyra parashikohet nga germa “c” e asaj dispozite. Meqenëse nga shqyrtimi i përmbajtjes dhe dispozitivit të vendimit rezulton shprehimisht shkarkimi i subjektit të rivlerësimit nga detyra, trupi gjykues i Kolegjit vëren se gjendemi dukshëm para një gabimi material, i cili nuk cenon arsyetimin apo pjesën urdhëruese të vendimit të shprehur të Komisionit e, për pasojë, as nuk përbën shkak për cenimin e vendimit.
21. Në vijim, më datë 07.02.2020, trupi gjykues i Kolegjit shpalli njoftimin për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 04.03.2020.<sup>21</sup>

*B. Arsyetimi i trupit gjykues për shkaqet e ankimit që lidhen çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale dhe procesit të rregullt ligjor*

22. Subjekti i rivlerësimit parashtron se Komisioni ka marrë vendim në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në mungesë koherence me provat e administruara, pasi është në kundërshtim me nenet 30, 31, 32, 34, 35, 38, 43, 44 dhe 61 pikat 2, 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë i njëanshëm dhe paragjykes. Ky pretendim është trajtuar gjerësisht në pjesën e këtij arsyetimi që shtjellon pretendimet lidhur me themelin e çështjes mbi procesin e rivlerësimit për të tria kriteret dhe me disponimin ligjor për aplikimin e masës disiplinore [paragrafët 30 – 38 më poshtë]. Në përfundim të analizës, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

**22.1.** Në këtë pjesë të arsyetimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje se rezultati i arritur nga Komisioni në përfundim të arsyetimit ligjor për secilin kriter, pavarësisht se është rishikuar nga Kolegji, nuk nënkupton që Komisioni ka qenë i njëanshëm, paragjykes, i paracaktuar apo që hetimi dhe vendimi kanë qenë formalë dhe të pambështetur në provat dhe në shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Vlerësimi i ndryshëm i rezultateve të procesit të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës dhe për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale nga ana e trupit gjykues të Kolegjit, është rezultat i interpretimit të të dhënave të dokumenteve në raport me ligjin e zbatueshëm, që nuk ndikon në rezultatin e konkluduar nga Komisioni. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit qëndron pjesërisht, për sa i përket vlerësimit të gabuar nga Komisioni të neneve 34, 35, 38, 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale, meqenëse për subjektin e rivlerësimit nuk u konstatuan probleme serioze me kontrollin e figurës dhe nuk rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. Megjithatë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky

<sup>19</sup> Trupi gjykues i Kolegjit i shortuar për këtë qëllim përbëhej nga gjyqtarët: Ina Rama – kryesuese, Ardian Hajdari, Luan Daci, Rezarta Schuetz dhe Albana Shtylla – anëtarë.

<sup>20</sup> Njoftuar në faqen zyrtare të Kolegjit - <http://kpa.al/njoftim-257/>.

<sup>21</sup> <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/02/Shpallje-njoftimi-per-gjykimin-e-%C3%A7eshites-ne-dhome-keshillimi.pdf>.



interpretim nuk është i mjaftueshëm për të ndryshuar vendimin e dhënë nga Komisioni për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

23. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka marrë vendim në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në mungesë koherence me provat e administruara, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 96/2016 dhe duke i atribuar vetes [Komisioni] kompetenca që u përkasin organeve të tjera, lidhur me vlerësimin e cenimit të figurës dhe etikës së magjistratit. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka respektuar nenin 43 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi nuk është kryer në harmoni me dokumentet e marra sipas shtojcës 4 të ligjit dhe të kriterëve të vlerësuar së bashku në mënyrë kumulative. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka vlerësuar të gjithë komponentët e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, në përputhje me tagrat ligjorë për ushtrimin e kompetencave të tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, ka rezultuar se ndërsa nga njëra anë subjekti i rivlerësimit është vlerësuar me një nivel kualifikues për tre komponentë të këtij kriteri, nga ana tjetër Komisioni ka vlerësuar se cenimi i etikës gjatë komunikimit me znj. F.L. dhe ndikimi i subjektit në emërimin e bashkëshortes në pozicionin e kryesekretares në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, ka ndikuar në cenimin e besimit të publikut te subjekti, si pjesë e sistemit të drejtësisë. Në përfundim edhe të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit që lidheshin me themelin e vlerësimit të këtij kriteri, trupi gjykues i Kolegjit evidenton se Komisioni ka vendosur të mos anashkalojë problemet e etikës, ndërsa ka treguar mirëkuptim për mangësitë e konstatuara lidhur me aftësitë organizative. Një arsytim më i hollësishëm i Kolegjit për këtë element shtjellohet në paragrafët më poshtë, 35-38. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.
24. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka lejuar shkelje procedurale, pasi vëzhguesi ndërkombëtar ka komentuar veprimet e subjektit të rivlerësimit, komente që kanë ndikuar në paracaktimin e vendimit. Nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës dëgjimore në fjalë [datë 18.12.2018], konstatohet se vëzhguesi ndërkombëtar ka shprehur një vlerësim profesional të tijin për çështjen e shkëmbimit të sms-ve me znj. L dhe punësimin e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit<sup>22</sup>. Neni B, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës sanksionon të drejtën e vëzhguesve ndërkombëtarë për të dhënë mendime mbi çështjet që shqyrtohen nga institucionet e rivlerësimit<sup>23</sup>. Nga ana tjetër, nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se Komisioni ka kryer një analizë të detajuar të mesazheve, të ngjarjeve dhe të shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës së kaluar për këtë çështje, pasqyruar ndër të tjera në vendimin e Komisionit në faqet 31-34. Për të gjitha këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.
25. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit ka qenë i paracaktuar dhe seanca dëgjimore është zhvilluar formalisht, pasi Komisioni ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe nuk ka marrë parasysh shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij. Nga analiza e vendimit në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe me aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit vëren se provat e paraqitura nga subjekti

---

<sup>22</sup> Sipas procesverbalit, vëzhguesi ndërkombëtar është shprehur ndër të tjera: “[...] nëse lexoni përmbajtjen e këtyre sms-ve, duken që janë të një njeriu jo thjesht të zhgënjyer, por më tepër, dhe fjalët e përdorura në këto sms janë kërcënuese [...]. Gjatë gjithë karrierës sime të gjatë në gjyqësor, nuk kam parë ndonjëherë këtë lloj sjelljeje dhe lloj keqpërdorimi të pushtetit/pozicionit, për të marrë përfitime personale (post zyrtar për gruan). [...]”

<sup>23</sup> Neni B, pika 3, germa “b” e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “[...] 3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: [...] b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelimit [...]”.

janë marrë në konsideratë në rishikimin e analizës financiare<sup>24</sup>, për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit dhe në shqyrtimin e dy kritereve të tjera. Nga e njëjta analizë, rezulton se Komisioni edhe gjatë seancës dëgjimore ka theksuar faktin se pretendimet, shpjegimet dhe dokumentet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, përfshirë komentet dhe deklaratimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, do të merren në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar. Rezultati përfundimtar i Komisionit nuk është diktuar nga moskonsiderimi i provave dhe i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, por nga interpretimi dhe vlerësimi i tyre, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit në raport me kërkesat ligjore. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

**25.1.** Lidhur me administrimin e provave në planin procedural në kontekst të garancive të normuara sipas nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje edhe jurisprudencën e GjEDNj-së, në çështjet *García Ruiz kundër Spanjës* ose *Farangë S.A. kundër Francës*. Në këto vendime, GjEDNj-ja e ka kushtëzuar konstatimin e respektimit të procesit të rregullt me kontradiktorialitetin dhe mundësinë dhënë palëve për të parashtruar prova dhe argumente, ndër të tjera. Sipas këtyre vendimeve, pranueshmëria dhe vlerësimi i provave mbi themelin në përgjithësi, janë kompetencë vetëm e gjykatave kombëtare, të cilat duhet të peshojnë elementet e mbledhura prej tyre<sup>25</sup>.

26. Subjekti i rivlerësimit parashtron se Komisioni ka dëshmuar mungesë serioziteti dhe vendimi ka qenë i paracaktuar, meqenëse më datë 17.12.2018, ora 16:00, i është dhënë afat për të paraqitur shpjegime dhe prova dhe më datë 18.12.2018, është zhvilluar seanca dëgjimore. Nga shqyrtimi i akteve në fashikull dhe i shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi për mungesë serioziteti dhe paracaktim të vendimit, nuk rezulton të mbështetet në fakte. Nga aktet në fashikull, rezulton se Komisioni i ka caktuar subjektit të rivlerësimit fillimisht datën 10.12.2018 për të paraqitur shpjegimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës së kaluar pas përfundimit të hetimit administrativ, më datë 27.11.2018. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dy kërkesa, një më datë 05.12.2018 dhe tjetrën më datë 10.12.2018, për të shtyrë afatin për ushtrimin e së drejtës për t'u njohur me materialet e dosjes dhe paraqitjen e provave të reja. Në njoftimin nëpërmjet postës elektronike për miratimin e kërkesës së dytë për shtyrje afati, më datë 10.12.2018, subjekti i rivlerësimit është njohur me datën e re të caktuar për të ushtruar të drejtën e njohjes me dosjen dhe për të paraqitur prova të reja (data 17.12.2018) dhe është ftuar për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore, të caktuar më datë 18.12.2018. Sipas një përllogaritjeje të thjeshtë të afateve kohore, rezulton se seanca dëgjimore është caktuar rreth 21 ditë nga e nesërmja e njoftimit me *e-mail* të rezultateve të hetimit administrativ, konkretisht nga data 27 nëntor - në datën 18 dhjetor 2018. Po kështu, trupi gjykues vëren se megjithëse subjektit të rivlerësimit iu mundësuan dy shtesa kohe, ai zgjodhi të mos e ushtronte të drejtën për t'u njohur me materialet e dosjes. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit se procesit të zhvilluar nga Komisioni i mungon serioziteti, rezulton i pambështetur nga faktet. Përkundrazi, analiza e mësipërme

<sup>24</sup> Shih paragrafin 4.5.b, faqja 13 e vendimit të Komisionit.

<sup>25</sup> Shih [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_ENG.pdf), paragrafi 322 – f. 64: “[...] Kur një ankesë e shkallës së katërt formulohet në fushën e nenit 6 § 1, gjykata e rrëzon kur konstaton se kërkuesi ka përfituar nga një proces me kontradiktoritet; se ka mundur, në stade të ndryshme të tij, të parashtronte argumentet dhe provat që ai i gjykonte të rëndësishme për mbrojtjen e rastit të vet; se ka mundur në mënyrë efektive të kontestojë argumentet dhe provat e prodhuara nga pala kundërshtare; se të gjitha argumentet e tij objektivisht të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes kanë qenë dëgjuar dhe shqyrtuar si duhet nga gjykata; se vendimi i kontestuar është arsyetuar gjerësisht, nga pikëpamja e faktit dhe e së drejtës; dhe se, për rrjedhojë, procesi i parë në tërësinë e vet ka qenë i rregullt [...]” (*García Ruiz kundër Spanjës, Dhoma e Madhe, § 29*).

dëshmon që Komisioni gjatë gjithë procesit ka respektuar të drejtat e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt dhe ka trajtuar me objektivitet kërkesat e paraqitura prej tij.

27. Subjekti i rivlerësimit parashtron faktin se raportet e ILDKPKI-së, DSIK-së dhe KLD-së janë pozitive, por Komisioni me përpjekjet tendencioze dhe të sforcuara ka dëshmuar që e ka paracaktuar çështjen që në fillim të procesit dhe se konstatimet e raportit të dytë të DSIK-së, lidhur me mosdeklarimin e dënimit të nipit për një vepër penale që nuk përfshihet në veprat penale që lidhen me krimin e organizuar apo mosrenditjen e tij si kontakt i papërshtatshëm, janë në kundërshtim me ligjin pasi, me përjashtim të të ndjerit Sh.K., nipërit e tij nuk kanë lidhje me krimin e organizuar dhe nuk janë pjesë e strukturave kriminale. Ky shkak ankimi është analizuar me hollësi në pjesën e arsytimit që lidhet me trajtimin e çështjeve të kriterit të kontrollit të figurës [paragrafi 34 i vendimit]. Sa i përket kontekstit procedural të këtij shkak ankimi, në analizë të pretendimeve të subjektit dhe akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren që ky pretendim rezulton i pabazuar në fakte. Nga analiza e vendimit, rezulton se Komisioni ka marrë në shqyrtim të gjitha raportet e paraqitura nga autoritetet e pavarura dhe ka kryer verifikime dhe hetime për çdo indicie që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje, ndër të tjera, arsyetimin ligjor të Komisionit në lidhje me papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës<sup>26</sup>, që përfaqëson pikërisht analizën e kryer mbi gjetjet e përcjella nga institucionet në fjalë. Ky qëndrim i Komisionit duket në përputhje edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit institucionet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se institucionet e rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses te të gjitha materialet përkatëse<sup>27</sup>. Edhe qëndrimi i shprehur i legjislatorit, në nenet 45 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, përcakton se institucionet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat relevante në procedurën e rivlerësimit dhe administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit. Në rastin konkret, konstatojmë se me marrjen e informacionit nga Ministria e Drejtësisë së Republikës Italiane më datë 28.09.2018, pas kërkesës së vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenin B, pika 3, germa “b” e Aneksit të Kushtetutës<sup>28</sup>, Komisioni ka marrë të dhëna të cilat mund të ndikojnë në raportin e DSIK-së për kontrollin e figurës. Kërkesa për rishikimin e raportit fillestar të DSIK-së, është praktikë e Komisionit.<sup>29</sup> Për rrjedhojë, nën dritën e fakteve të analizuar më sipër, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbetet i pambështetur në fakte.
28. Subjekti i rivlerësimit pretendon se qëllimi i Komisionit ka qenë arritja e një rezultati të paracaktuar, të ndikuar nga faktorë jashtë procesit, gjë që ishte e dukshme nga momenti i nisjes së hetimit administrativ, pyetjet e drejtuara, koha e shkurtër në dispozicion për t’u përgjigjur, dërgimi i pyetjeve jashtë orarit zyrtar. Në disa raste, pyetjet kërkonin kohë pasi kishin të bënin me fakte të ndodhura deri në 25 vite larg.

**28.1.** Trupi gjykues i Kolegjit, duke sjellë në vëmendje arsyetimin dhe analizën e pasqyruar në paragrafin 26 të këtij vendimi, vëren se edhe ky pretendim është i pabazuar, pasi siç është

<sup>26</sup> Shih faqen 26 të vendimit të Komisionit.

<sup>27</sup> Shih paragrafët 38 dhe 39 të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, në: [http://www.gjk.gov.al/web/Lista\\_e\\_Vendimeve\\_92\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php).

<sup>28</sup> Neni B, pika 3, germa “b” e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “[...] Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: [...] kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit Dh. [...] vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit [...]”.

<sup>29</sup> Praktikë e zbatuar nga Komisioni, pasqyruar ndër të tjera në vendimet nr. 41, datë 18.07.2018; nr. 93, datë 21.12.2018; nr. 95, datë 08.01.2019; nr. 124, datë 26.03.2019 të Komisionit.

theksuar edhe më sipër, Komisioni ka përfunduar hetimin paraprak administrativ dhe ka miratuar rezultatet paraprake të hetimit më datë 27.11.2018. Njëherësh, Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për kalimin e barrës së provës, duke i caktuar si afat për t'u njohur me dosjen, për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve deri më datë 10.12.2018 – 13 ditë kohë nga e nesërmja e njoftimit. Më datë 05.12.2018, subjekti i rivlerësimit kërkoi në rrugë elektronike shtyrjen e afatit për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova mbi rezultatet e hetimit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, afati u zgjat edhe tri (3) ditë, deri më datë 13.12.2018 – duke shkuar kështu në 16 ditë nga njoftimi i rezultateve të hetimit.

**28.2.** Më datë 10.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kërkesë të dytë për të shtyrë afatin, në mënyrë që të njihej me materialet e dosjes dhe paraqitjen e provave të reja. Po atë ditë, më datë 10.12.2018, Komisioni zgjati afatin edhe me shtatë (7) ditë të tjera, deri më 17.12.2018, dhe ftoi subjektin për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, më datë 18.12.2018. Më datë 17.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka dërguar në rrugë elektronike shpjegimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit paraprak. Po kështu, gjatë hetimit administrativ dhe procesit në Komision, që zgjati nga marsi deri në dhjetor 2018, për mbi tetë muaj, për të sqaruar faktet dhe rrethanat e rezultuara gjatë hetimit, Komisioni i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit pesë (5) pyetësorë, duke i dhënë kohë për të dhënë përgjigje dhe për të bashkëlidhur prova, përpos kohës shtesë përpara seancës dëgjimore, prej tri javësh – 27.11.2018 deri në 18.12.2018. Më konkretisht:

- pyetësori nr. 1, dërguar më datë 24.04.2018 dhe kthyer përgjigje më datë 03.05.2018 (9 ditë);
- pyetësori nr. 2, dërguar më datë 26.09.2018 dhe kthyer përgjigje më datë 04.10.2018 (8 ditë);
- pyetësori shtesë, dërguar më datë 10.10.2018 dhe kthyer përgjigje më datë 17.10.2018 (7 ditë);
- pyetje specifike, dërguar më datë 02.11.2018 dhe kthyer përgjigje më datë 07.11.2018 (5 ditë);
- pyetje të tjera, dërguar më datë 12.11.2018 dhe kthyer përgjigje më datë 16.11.2018 (4 ditë).

**28.3.** Trupi gjykues i Kolegjit po ashtu sjell në vëmendje që pretendimi i subjektit të rivlerësimit për kohë të pamjaftueshme për t'u përgjigjur pyetjeve dhe për të paraqitur prova, për herë të parë ngrihet në ankim. Nuk rezulton që gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit të ketë parashtruar pretendime lidhur me kohën e shkurtër në dispozicion për paraqitjen e provave dhe akteve në përmbushje të barrës së provës. Duke pasur parasysh këto elemente, e konkretisht që vetëm pjesa e korrespondencës dhe mundësia e tij për të dhënë shpjegime dhe prova ka zgjatur tetë muaj, ka përfshirë edhe kohë shtesë, dhe që mungesa e kohës për të është ngritur për herë të parë në ankim, pretendimi i subjektit për vendim të paracaktuar nga Komisioni nuk qëndron. Në shqyrtimin në tërësi të shkaqeve të ankimit që lidhen me interpretimin e ligjit, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstatoi veprime apo qëndrime të Komisionit që shprehin natyrë tendencioze apo që sugjerojnë ndikim nga faktorë jashtë procesit, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit.

- 29.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është në kundërshtim të hapur me nenin 17 të Kushtetutës dhe dispozitat e neneve 6, 7, 8, 13 dhe 14 dhe protokollet shtesë të KEDNj-së. Konkretisht, shkeljet e pretenduara nga subjekti lidhen me parimet e procesit të rregullt ligjor, e drejta e privatësisë familjare, e drejta për mosdënim ose ndëshkim pa ligj, e drejta për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, e drejta për një proces të pavarur dhe të paanshëm gjykimi dhe e drejta për prezumimin e pafajësisë.

**29.1.** Trupi gjykues i Kolegjit, në vazhdim dhe rikujtesë të arsyetimit më sipër, nga analiza e vendimit, akteve në fashikull dhe shkaqeve të ankimit, çmon se subjektit të rivlerësimit i është garantuar e drejta për një proces të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNj-së) dhe, për rrjedhojë, pretendimi nuk qëndron. Nga shqyrtimi i të gjithë procesit të rivlerësimit të ndjekur nga Komisioni, konstatohet se subjekti i rivlerësimit i ka gëzuar të gjitha garancitë procedurale që lidhen me mundësinë për të dhënë shpjegime me shkrim dhe me gojë gjatë procesit të hetimit administrativ, kohën e nevojshme për të paraqitur prova dhe dokumente, si dhe mundësinë për të njohur dosjen e administruar nga Komisioni. Këtë të drejtë të fundit, subjekti rezulton të ketë zgjedhur të mos e ushtrojë. Komisioni ka përmbushur kërkesat e subjektit për shtyrje të afatit për të ushtruar të drejtat që lidhen me barrën e provës, duke dhënë dy shtesa afati dhe mundësinë që të paraqiste prova dhe dokumente që i vlerësonte të nevojshme për t'u mbrojtur. Po kështu, edhe gjatë seancës dëgjimore në Komision, subjekti të rivlerësimit i është garantuar e drejta për t'u përfaqësuar nga një avokat i licencuar, i zgjedhur prej tij. Nga shqyrtimi në Kolegj i akteve në fashikull, përfshirë edhe analizën e vendimit, rezulton se Komisioni ka respektuar garancitë kushtetuese që lidhen me barazinë përpara ligjit, kontradiktorialitetin, mundësinë dhe kohën e nevojshme për t'u mbrojtur, parime që së bashku përbëjnë themelin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në vendim, Komisioni rezulton të ketë marrë në analizë dhe vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe të jetë mbështetur në provat që disponon, sikurse është shprehur në vlerësimin që i ka bërë secilit kriter dhe çështjes në tërësi.

**29.2.** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se është shkelur e drejta për një proces gjykimi të pavarur dhe të paanshëm, nuk duket të jetë ilustruar me veprime të kryera nga Komisioni, të cilat në këndvështrimin e subjektit kanë përbërë shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të pavarur dhe të paanshëm. Për rrjedhojë, analiza e këtij pretendimi, si edhe i atyre më sipër, do të vijojë në planin e përgjithshëm, në mungesë të indicieve në ankim apo treguesve të veprimeve që sipas subjektit kanë përbërë shkelje. Parimet në fjalë, si bazë e procesit të rivlerësimit, janë sanksionuar në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në nenet 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtyre dispozitave, institucionet e rivlerësimit ushtrojnë funksionet si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në analizë të akteve në fashikull, duke pasur parasysh sidomos, por jo vetëm, procesverbalin e seancës gjyqësore, pyetësorët, korrespondencën mes subjektit dhe Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton veprime të Komisionit të cilat në vetvete mund të përbënin cenim të së drejtës së subjektit për një proces gjykimi të pavarur dhe të paanshëm apo janë tejkallim i tagrave të Komisionit për vendimmarrje apo hetim. Në këtë dritë, sjellim në vëmendje edhe analizën kronologjike të kryer më sipër për kohëzgjatjen e procesit të hetimit, që ndër të tjera provon se hetimi dhe procesi në Komision nuk rezultuan të kenë shkelur të drejta procedurale të subjektit.

**29.3.** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se është shkelur e drejta për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, nuk qëndron. Kjo e drejtë materializohet në ligj nëpërmjet ekzistencës dhe funksionimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në shqyrtimin e ankimeve, përfshirë edhe ankimin konkret të subjektit të rivlerësimit. Ky ka qenë edhe qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, që në analizë të respektimit të këtyre garancive nga ligjet që krijuan institucionet e rivlerësimit, *vis a vis* procesit të rregullt, është shprehur:

“[...] Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që

kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...]”<sup>30</sup>.

**29.4.** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për shkelje të nenit 7 të KEDNj-së, nuk qëndron në një proces me natyrë administrative. Kjo dispozitë e Konventës, materializuar në nenin 29 të Kushtetutës, lidhet ngushtë me të drejtat e individëve në procesin penal<sup>31</sup>, siç pasqyrohet qartë në secilën nga tri fjalitë që përbëjnë dispozitën. Procesi i rivlerësimit, një proces ngushtësisht administrativ, mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe nënligjor, dhe përcakton rastet e dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, si ndëshkim i parashikuar në ligj. Për shkak të natyrës administrative, procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e ligjit të posaçëm dhe dispozitat e ligjit nr. 49/2012 që rregullon veprimtarinë dhe parimet mbi të cilat bazohet procesi në gjykatat administrative. Për këto arsye, duke qenë përpara një pretendimi për shkelje të një të drejte që lind në një proces të palidhur me procesin e rivlerësimit, sikurse e drejta për mosdënim ose ndëshkim pa ligj, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të panevojshme analizën e mëtejshme në këtë drejtim. I njëjti arsyetim vlen edhe për pretendimin për shkelje të prezumimit të pafajësisë, i cili është një parim i proces penal. Trupi gjykues i Kolegjit gjen me vend të theksojë që në procesin e rivlerësimit [profesional] kushtetutëbërësi, në nenin Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në ndryshim nga procesi penal, ka përcaktuar që barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces. Ky parim është zbërthyer në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të kryer nga Komisioni.

**29.5.** Përpos neneve 6 dhe 7, subjekti pretendon shkeljen e nenit 8 të KEDNj-së, të drejtën e privatësisë dhe jetës familjare. Edhe në rastin e kësaj dispozite, në ankim nuk shpjegohet cilat veprime të Komisionit përbënin shkelje të së drejtës për privatësi familjare apo në ç’mënyrë është konstatuar prej tij një shkelje e tillë nga Komisioni. Për rrjedhojë, arsyetimi i mëposhtëm i trupit gjykues është i përgjithshëm dhe merr në analizë procesin e rivlerësimit në tërësi, në mungesë të indicieve apo pretendimeve për veprime specifike të Komisionit, të cilat për subjektin kanë përbërë shkelje të këtyre parimeve në procesin e rivlerësimit të tij. Neni A i Aneksit të Kushtetutës, në funksion dhe përgjatë procesit të rivlerësimit, parashikon kufizime të të drejtave kushtetuese, sipas kushteve të parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës, që lidhen me respektimin e jetës private, si dhe dispozitat që lidhen me barrën e provës<sup>32</sup>. Neni 17 i Kushtetutës parashikon garancinë e kufizimeve të të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, ndër të tjera për një interes publik<sup>33</sup>.

<sup>30</sup> Shih paragrafin 67 të vendimit në: [http://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php).

Të njëjtën qasje ka shprehur edhe Komisioni i Venecias në opinionin e tij CDL-AD (2016)036 [paragrafët 37 dhe 38] – shih [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e)

<sup>31</sup> Neni 7 i KEDNj-së parashikon: “1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale. 2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara”.

<sup>32</sup> Neni A, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës: “1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “f”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës [...]”.

<sup>33</sup> Sipas nenit 17 të Kushtetutës: “[...] 1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

**29.6.** Përputhshmëria me Kushtetutën dhe nenin 8 të KEDNj-së e kufizimeve me ligj të së drejtës së privatësisë në funksion dhe brenda nevojave të procesit të rivlerësimit, është konstatuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila është shprehur se:

“[...] Gjykata vëren se ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret, ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNj-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë [...]”<sup>34</sup>.

**29.7.** Në dritën e dispozitave kushtetuese më sipër dhe pas analizës së detajuar të procedurës së ndjekur nga Komisioni në procesin konkret, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për shkeljen e të drejtës së privatësisë familjare, nuk qëndron. Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni rezulton të ketë respektuar kriteret dhe kornizën ligjore të parashikuar për këtë qëllim. Nga studimi i akteve të administruara në fashikuj, trupi gjykues i Kolegjit nuk vëren tejkalime të kufizimit të së drejtës së privatësisë familjare gjatë hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit dhe as shkelje të së drejtës së barrës së provës. Subjekti ka qenë i informuar për kalimin e barrës së provës, përfshirë edhe në përfundim të hetimit administrativ më 27.11.2018, në përgjigje të të cilit ka dorëzuar një material shpjegues prej 10 faqesh dhe ka sjellë 18 akte në mbështetje të shpjegimeve të tij. Së fundmi, në seancën dëgjimore apo edhe gjatë gjithë procesit në Komision, nuk rezulton të ketë ngritur prapësime apo pretendime për shkelje të nenit 8 të KEDNj-së. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar.

**29.8.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren që edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të të drejtave të sanksionuara në nenet 13 dhe 14 të KEDNj-së dhe në protokollat përkatëse shtesë, respektivisht, e drejta për *zgjidhje efektive* dhe *ndalimi i diskriminimit*, janë të pabazuara në prova. Për të dyja këto pretendime, trupi gjykues vëren se në ankim nuk specifikohet se në ç’mënyrë, formë apo veprime Komisioni ka shkelur këto dy garanci. Për parimin e zgjidhjes efektive, trupi gjykues i referohet arsyetimit të mësipërm në paragrafin 29.3 dhe rikujton që vetë rishikimi i vendimit nga ana e Kolegjit, çfarë në thelb përbën edhe ky vendim, është garancia e vendosur nga ligjvënësi në funksion dhe zbatim të nenit 13 të KEDNj-së. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, është shprehur se:

“Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislativë dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (*shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias*)”<sup>35</sup>.

**29.9.** Subjekti pretendon se procesi i zhvilluar në Komision për rivlerësimin e tij ka qenë në shkelje të nenit 14 të KEDNj-së. Neni 14 parashikon:

“[...] Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si: seksi, raca, ngjyra, gjuha,

<sup>34</sup> Shih paragrafin 64 të vendimit nr. 2/2017 në: [http://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php).

<sup>35</sup> Shih paragrafin 66 të vendimit nr. 2/2017 në: [http://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php). Të njëjtën qasje ka shprehur edhe Komisioni i Venecias në opinionin e tij CDL-AD (2016)036, në paragrafin 63 të tij, ku Kolegji konsiderohet një juridiksion i specializuar që paraqet garanci gjyqësore për subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit. Shih edhe: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër [...]”.

Nga aktet e administruara në fashikuj, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të gëzojë një nga cilësitë e përhershme të mbrojtura me këtë garanci e konkretisht: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike, origjina kombëtare apo shoqërore, përkatësia në një minoritet, apo status tjetër. Po ashtu, si edhe u vu në pah referuar pretendimeve të tjera të tij për shkelje procedurale, edhe në rastin e nenit 14 të KEDNj-së, subjekti i rivlerësimit nuk ilustron cilat veprime të Komisionit kanë përbërë diskriminim të tij dhe mbi cilën bazë përkatësie të tij, të mbrojtur nga ky parim. Në mungesë të pretendimeve konkrete, trupi gjykues i Kolegjit, duke e gjetur të pamundur analizën e mëtejshme, vëren që ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe i pambështetur në prova, përveçse i pailustruar me veprime konkrete.

**29.10.** Subjekti pretendon se ka dyshime për paanshmërinë e anëtares së trupit gjykues, komisioneres Xhensila Pine, pas një incidenti të ndodhur gjatë hedhjes së shortit për përzgjedhjen e dosjeve për procesin e rivlerësimit për gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, ku subjekti ishte i pranishëm në funksion të detyrës së tij si kryetar. Sipas tij, kjo njëanshmëri u vërtetua me dhënien e vendimit përfundimtar në Komision. Në analizë të akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se përbërja e trupit gjykues në Komision, sipas shortit fillestar të datës 15.03.2018, i është njoftuar subjektit me *e-mail* më datë 06.06.2018. Për arsye objektive, anëtarja e trupit gjykues, znj. Alma Faskaj, u zëvendësua më datë 16.07.2018 nga komisionerja Xhensila Pine. Ky vendim i është njoftuar subjektit me *e-mail* më datë 27.11.2018. Më datë 03.12.2018, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë për përjashtimin e komisioneres Xhensila Pine. Më datë 04.12.2018, një tjetër trup gjykues i Komisionit, duke e konstatuar të pabazuar në prova dhe në ligj, mori vendim të mos e pranojë këtë kërkesë. Në të dyja vendimet e formimit të trupit gjykues, anëtarët kanë deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me subjektin e rivlerësimit, duke plotësuar edhe deklaratat përkatëse. Vërejmë që vendimi përfundimtar i Komisionit që vendosi shkarkimin e subjektit, është marrë në mënyrë unanime, çka tregon se analiza e fakteve dhe provave bindi të tre komisionerët njëherazi, gjë që dëshmon se anshmëria e znj. Pine mbetet e paprovuar. Lidhur me qëndrimin e paanshëm të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve, Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar referuar jurisprudencës së GjEDNj-së. Kjo e fundit është shprehur se për të vendosur, në një çështje të dhënë, mbi ekzistencën e një arsyeje të justifikuar për të dyshuar se në një trup gjykues mungon paanshmëria, duhet përcaktuar nëse, pavarësisht nga sjellja personale e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues, ekzistojnë fakte të verifikueshme që lejojnë të dyshosh në paanshmërinë e vetë trupit gjykues. Pra, për të vendosur, në një çështje të dhënë, mbi ekzistencën e një arsyeje të justifikuar për të dyshuar për mungesë paanshmërie të një gjyqtari (*Morel kundër Francës*, §§ 45-50; *Pescador Valero kundër Spanjës* § 23) ose të një trupi gjykues (*Luka kundër Rumanisë*, § 40), këndvështrimi i një personi të interesuar merret parasysh, por nuk luan rol vendimtar. Përcaktuese është të zbulohet nëse shqetësimet e të interesuarit mund të konsiderohen si të justifikuar objektivisht (*Wettstein kundër Zvicrës* §44; *Pabla Ky kundër Finlandës* §30; *Micalleff kundër Maltës [Dhoma e Madhe]*, §96)<sup>36</sup>. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.

*C. Arsyetimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

30. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka interpretuar gabim dispozitat ligjore dhe provat e paraqitura kur ka konkluduar pasaktësi që lidhen me burimin e të ardhurave për dhënien e dy

<sup>36</sup> Shih [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_ENG.pdf) – paragrafi 242.



huave. Subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme të të ardhurave të gjeneruara për vitet 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2008, dhe mundësi për të kursyer ndër vite gjendjen *cash* të deklaruar. Në të ardhurat e ligjshme, subjekti i rivlerësimit kërkon të merret në konsideratë se shuma prej 314.643 lekësh rrjedh nga kursimet para vitit 2003, shuma prej 139.086 lekësh rrjedh nga një veprim i gabuar i punonjësës së bankës për vitin 2005 – 2006, ndërsa shuma prej 699.231 lekësh për vitin 2008, është derivat i një kredie të marrë nga bashkëshortja e subjektit për babanë e saj, në vlerën 700.000 lekë.

**30.1.** Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton sa vijon.

i) Më datë 03.04.2014, z. M.M. ka deklaruar se i ka marrë hua subjektit të rivlerësimit, pa shpërblim, pa interes apo pa kamatë vonese, shumën 7.000.000 lekë, për një periudhë 2-vjeçare. Më datë 03.04.2016, subjekti i rivlerësimit deklaroi shtyrjen e afatit për shlyerjen e huas, për shkak të pamundësisë së pagimit të huas në kohën e rënë dakord, edhe për një periudhë 2-vjeçare, deri më 03.04.2018. Subjekti e ka deklaruar huan dhënë z. M. në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë (në vijim “deklarata e interesave privatë”) për vitin 2014<sup>37</sup>, 2015, 2016<sup>38</sup> dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”)<sup>39</sup>.

ii) Më datë 20.02.2015, z. A.P. deklaroi se i ka marrë hua subjektit të rivlerësimit pa shpërblim, pa interes apo pa kamatë vonese, shumën 1.400.000 lekë ose 10.000 euro, për një periudhë 2-vjeçare. Edhe këtë hua, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë për vitin 2015<sup>40</sup>, 2016 dhe në deklaratën *vetting*<sup>41</sup>. Më datë 30.07.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se kjo hua i është kthyer.

**30.2.** Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013 [të dorëzuar më datë 25.03.2014], subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen *cash* në masën 7474.331 lekë<sup>42</sup>. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014 [të dorëzuar më datë 30.03.2015], subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: dhënie hua pa interes në shumën 7.000.000 lekë, vlerën 900.000 lekë, si shumë të shtuar të rrjedhur nga kursimet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, dhe vlerën 1.374.331 lekë si gjendje *cash* të mbetur. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2015 [të dorëzuar më datë 29.03.2016], subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të dyja huatë, atë në vlerën 7.000.000 lekë, dhënë z. M.M., dhe atë në vlerën 1.400.000 lekë, dhënë z. A.P., shumën e shtuar në vlerën 800.000 lekë, të rrjedhur nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, dhe vlerën 774.331 lekë si gjendje *cash*<sup>43</sup>.

**30.3.** Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka pasur të pamundur të krijonte gjendjen e deklaruar në fund të vitit 2013 të kursimeve *cash* prej 7474.331 lekësh. Sipas kësaj analize, mundësia reale për të kursyer deri më datë 31.12.2013,

<sup>37</sup> Me shënimin: deklarata e datës 17.09.2014, vërtetuar me aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 17.09.2014.

<sup>38</sup> Me shënimin: deklarata e vërtetuar me aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 17.09.2014 dhe deklarata e vërtetuar me aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 06.10.2016.

<sup>39</sup> Deklarata është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI më datë 27.01.2017. Në deklarata është shënuar deklarata e datës 03.04.2014, vërtetuar me aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 17.09.2014 dhe deklarata e datës 03.04.2016 vërtetuar me aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 06.10.2016.

<sup>40</sup> Me shënimin: deklarata e vërtetuar me aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 01.12.2015.

<sup>41</sup> Me shënimin: deklarata e datës 20.02.2015, e vërtetuar me aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 01.12.2015.

<sup>42</sup> Përlllogaritur si shumë e vlerës së deklaruar në deklarata e interesave vjetorë për vitin 2012 prej 6.674.331 lekësh, si gjendje *cash*, dhe vlerës prej 800.000 lekësh, e konsideruar si shumë e shtuar, e rrjedhur nga kursimet nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij.

<sup>43</sup> Raportimi i veprimeve noteriale të kryera për dhënie të dy huave dorazi është konfirmuar edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2017.

ka qenë në vlerën 6871518 lekë<sup>44</sup>. Duke mbajtur në konsideratë se huaja prej 7000000 lekësh i është dhënë z. M. në datën 03.04.2014, në analizën financiare në Kolegj u përfshinë edhe të ardhurat e vitit 2014 deri në dhënien e huas, konkretisht ato të periudhës 01.01.2014 - 03.04.2014. Si rezultat, nga përlllogaritja e të ardhurave deri në prill 2014, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mundësi për të kursyer 316660 lekë për periudhën 01.01.2014 - 03.04.2014<sup>45</sup>, mjaftueshëm për të përballuar pjesën e pambuluar deri në 31.12.2013, prej 128482 lekësh. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar kursimet e deklaruara deri më 31.12.2013, prej 7474331 lekësh, por ka pasur mundësi financiare ta plotësojë shumën e dhënë hua në vlerën 7000000 lekë z. M.M. deri në datën 03.04.2014.

**30.4.** Në vijim, analiza financiare në Kolegj, në funksion të vlerësimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me dy huatë e dhëna nga subjekti në vitet 2014 dhe 2015, u përqendrua edhe në mundësitë e subjektit për të poseduar *cash* në banesë në vlerën e deklaruar prej tij, prej 1374331 lekësh. Nga analiza rezultoi se mundësia teorike/reale e subjektit për të kursyer deri në fund të vitit 2014 ka qenë në vlerën 900000 lekë, duke marrë në konsideratë se të gjitha kursimet e mundshme të subjektit të rivlerësimit deri në datën 03.04.2014, janë përdorur për huan që i është dhënë z. M.M.<sup>46</sup>. Analiza financiare ka përfshirë edhe periudhën 01.01.2015 - 20.02.2015, duke marrë në konsideratë datën e dhënies së huas prej 1400000 lekësh z. P. [20.02.2015]. Me gjithë përfshirjen edhe të të ardhurave deri në shkurt 2015, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në gjendje të japë shumën e huas prej 1400000 lekësh z. A.P., më datë 20.02.2015. Mundësia reale financiare teorike deri në këtë datë ka qenë 1009518 lekë dhe pamundësia financiare për të plotësuar shumën e dhënë hua është në vlerën 390482 lekë<sup>47</sup>. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se qëndron konstatimi i

---

<sup>44</sup> Kjo shifër ka rezultuar si diferencë ndërmjet të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes me shpenzimet e jetesës për vitin 2013, të përlllogaritura sipas metodologjisë së INSTAT referuar ILDKPKI-së, si dhe shtesat e likuiditeteve në gjendjet e bankës — e nxjerrë si diferencë midis totalit të likuiditeteve në bankë të llogarive në datën 31.12.2013 dhe totalit të likuiditeteve në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në datën 31.12.2012. Sipas Komisionit, mundësia reale për të kursyer deri në fund të vitit 2013, ka qenë në shumën prej 6483709 lekësh (shih faqen 12 të vendimit).

<sup>45</sup> Kjo shifër ka rezultuar si diferencë ndërmjet të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për periudhën 01.01.2014 - 03.04.2014 (totali i kreditimeve të pagave në llogaritë përkatëse bankare për periudhën 01.01.2014 - 03.04.2014) me shpenzimet e jetesës për tre muaj e tre ditë, të përlllogaritura sipas metodologjisë së INSTAT referuar ILDKPKI-së, si dhe shtesat e likuiditeteve në gjendjet e bankës — e nxjerrë si diferencë midis totalit të likuiditeteve në bankë të llogarive në datën 03.04.2014 dhe totalit të likuiditeteve në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në datën 31.12.2013. Dokumentacioni nga bankat e nivelit të dytë është administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

<sup>46</sup> Sipas Komisionit, mundësia reale për të kursyer deri në fund të vitit 2014, ka qenë në shumën 986836 lekë (shih faqen 16 të vendimit).

<sup>47</sup> Referuar përlllogaritjes së shpjeguar në paragrafin 30.3 të këtij vendimi, duke konsideruar faktin se të gjitha kursimet e subjektit të rivlerësimit janë përdorur për huan dhënë z. M. M., përjashtohet mundësia për kursime të tjera “cash” në banesë në datën 31.12.2013. Për rrjedhojë, mundësia reale për të kursyer deri në datë 20.02.2015 — kur i është dhënë huaja z. A.P. — është përlllogaritur duke mbajtur në konsideratë kursimet “cash” të deklaruara nga subjekti për vitin 2014, prej 900000 lekësh, që sipas analizës financiare të kryer në Kolegj rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi reale të kursejë gjatë vitit 2014, si dhe kursimet e mundshme për periudhën 01.01.2015 deri në 20.02.2015. Mundësia reale për të kursyer për periudhën 01.01.2015 - 20.02.2015 është në vlerën 1009518 lekë. Kjo e fundit rezultoi nga diferenca ndërmjet të ardhurave totale të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij për periudhën 01.01.2015 - 20.02.2015 (totali i kreditimeve të pagave në llogaritë përkatëse bankare për periudhën 01.01.2015 - 20.02.2015) me shpenzimet e jetesës të përlllogaritura sipas metodologjisë të përdorur nga ILDKPKI për një muaj e 20 ditë, si edhe shtesat e likuiditeteve në gjendjet e bankës (e nxjerrë si diferencë midis totalit të likuiditeteve në bankë të llogarive gjendje në datën 20.02.2015 dhe totalit të likuiditeteve në bankë të llogarive gjendje në datën 31.12.2014, të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij - sipas konfirmimeve të bankave të nivelit të dytë të administruara nga Komisioni.

Komisionit se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me kursimet familjare si burim krijimi i shumës së dhënë hua z. A.P. Subjekti nuk ka qenë në gjendje ta krijonte këtë shumë deri më datë 20.02.2015. Në vijim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të dhënë huan në vlerën 1.400.000 lekë z. A.P.

31. Subjekti i rivlerësimit e konsideron joetik dhe joprofesional konkluzionin e Komisionit që deklaratat noteriale të bashkëshortes dhe djalit të të ndjerit H.M. (respektivisht vjehrra dhe kunati i subjektit), të redaktuara në muajt nëntor dhe dhjetor 2018, ishin akte deklarative të njëanshme, në tentativë për të justifikuar pretendimet e tij. Subjekti i ka kërkuar Komisionit që në rast të pamjaftueshmërisë së këtyre dy deklaratave, deklaruesit mund të pyeteshin si dëshmitarë për të provuar që kredia e marrë në vitin 2007 nga bashkëshortja e tij, ishte për llogari të të atit të saj, të ndjerit H.M.

31.1. Nga aktet rezulton se znj. S.K. ka marrë kredi bankare në vlerën 700.000 lekë (me interes 7%, me afat 24 muaj) më datë 27.08.2007. Kredia është shlyer brenda shtatë (7) muajve, 17 muaj përpara afatit, më datë 28.03.2008<sup>48</sup>. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë detyrim financiar në deklaratën e interesave privatë për vitet 2007 dhe 2008, si kredi e marrë në mirëbesim nga bashkëshortja e tij, si punonjëse e Bankës Raiffeisen, Dega {\*\*\*}, për të ndihmuar biznesin e babait të saj dhe që shlyhet rregullisht/totalisht nga ana e tyre. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kredia është shlyer nga i ndjeri H.M. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ<sup>49</sup> të datës 17.12.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se kështu dhe likuidimi i kredisë janë paguar dorazi nga babai i bashkëshortes. Për të mbështetur këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur deklaratat noteriale të bëra gjatë procesit të rivlerësimit, në nëntor dhe dhjetor 2018, nga z. B.M. dhe znj. Z.M. Subjekti ka kërkuar nga Komisioni që të mund të pyeten në cilësinë e dëshmitarëve këta dy persona, nëse deklaratat nuk do të vlerësoheshin të mjaftueshme.

31.2. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron dhe konstatimi i Komisionit është i drejtë dhe i bazuar në dokumentacionin e administruar për këtë qëllim. Ky vlerësim mbështetet në faktin që në aktet e administruara në Komision, nuk ekziston asnjë dokument shkresor, bankar apo i çfarëdo lloji tjetër, që të provojë pretendimin e subjektit se ndryshe nga sa provojnë dokumentet, shuma në të vërtetë i ka shërbyer të ndjerit H.M. Mungojnë po ashtu edhe dokumentet që të tregojnë edhe indirekt kalimin e shumës prej 700.000 lekësh në llogari të tij. Së fundmi, mungon çdo lloj prove dokumentare që të vërtetojë pagesën e shumave të kësteve, duke përfshirë dhe interesat apo dhënien e tyre dorazi ose në rrugë bankare prej z. M., të bijës, znj. S.K., në momentin kur ato pretendohet të kenë ndodhur — në vitet 2007 dhe 2008. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe nëse Komisioni do të thërriste në cilësinë e dëshmitarëve z. B.M. dhe znj. Z.M., dëshmia e tyre nuk do të kishte ndonjë vlerë të shtuar në hetimin e kryer, në mungesë të dokumentacionit të kohës që të provojë pretendimin e subjektit se kredia i është dhënë dhe është shlyer nga z. H.M. Ky vlerësim i trupit gjykues të Kolegjit është në përputhje edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së në çështjen *Wierbicki*, sipas së cilës kundërshtimi për të thirrur një dëshmitar duhet të motivohet dhe të mos jetë arbitrar, në mënyrë që të mos shërbejë për të kufizuar në mënyrë të shpërpjesëtuar aftësinë e ndërgjyqësit për të paraqitur argumentet e tij në mbështetje të rastit të vet<sup>50</sup>. Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse Komisioni, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklarimit të rremë duke qenë se ky detyrim financiar është deklaruar prej tij në deklaratat e interesave privatë të viteve 2007 dhe 2008. Nga ana

<sup>48</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 10.04.2018, nga Banka Raiffeisen, Dega {\*\*\*}.

<sup>49</sup> Faqja 4 e shpjegimeve për analizën financiare të vitit 2008.

<sup>50</sup> Shih: Çështja *Wierbicki k. Polonisë*, paragrafi (§) 45

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%22itemid%22:%22001-60507%22>

tjetër, meqenëse dokumentacioni bankar, përfshirë vërtetimet, kontrata e kredisë dhe lëvizjet e llogarisë së znj. S.K. në Bankën Raiffeisen provojnë se kredia është disbursuar dhe është shlyer prej saj, trupi gjykues i Kolegjit e përfshiu këtë shumë në analizën financiare.

**31.3.** Në vijim të sa më sipër, pas kryerjes së analizës financiare për dy periudha të ndara, fillimisht për periudhën deri më datë 03.04.2014, që përkon me datën e huas së dhënë z. M., dhe më pas për periudhën 01.01.2014 – 20.02.2015, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për dhënien e huas z. M.M., më datë 03.04.2014, por ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e shumës që ka shërbyer më pas për dhënien e huas z. A.P., më datë 20.02.2015. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mbulimin me të ardhura të ligjshme të shumës që ka shërbyer për një nga huatë nuk qëndron. Konstatimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka qenë i pasaktë në deklaratimet për kursimet familjare, si burim krijimi i shumës së dhënë hua z. A.P., është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në gjendje të krijonte këtë shumë me burime financiare të ligjshme.

- 32.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumën prej 1.186.981 lekësh (për periudhën 2003 – 2016) pasi, sipas tij, nga puna e tij dhe e bashkëshortes janë gjeneruar të ardhura të mjaftueshme dhe të ligjshme duke filluar nga viti 1993. Sipas tij, kjo diferencë negative përbëhet nga: a) vlera negative e përlllogaritur gabim në analizën financiare të Komisionit për vitin 2003, prej 314.643 lekësh, me arsyetimin se depozita bankare e deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003, në shumën 730.108 lekë, pranë Bankës së Kursimeve {\*\*\*}, nuk janë kursime të vitit 2003, por kanë si burim krijimi të deklaruar kursime nga të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e tij dhe të bashkëshortes që nga momenti që kanë filluar punë; b) diferenca negative e përlllogaritur në analizën financiare të Komisionit për vitin 2005, prej 167.945 lekësh, që rezulton si pasojë e një gabimi të bërë nga vetë banka në fund të vitit 2005 dhe mbartur gabim dhe në fillim të vitit 2006<sup>51</sup>, rregulluar nga vetë banka; c) si dhe nga diferenca negative prej 699.231 lekësh, e rezultuar nga analiza financiare e Komisionit për vitin 2008, e cila lidhet me kredinë e marrë nga bashkëshortja për babanë e saj dhe e shlyer *de facto* nga ky i fundit.

**32.1.** Në analizë të akteve në fashikull dhe shkaqeve të ankimit, bazuar në analizën financiare, shpjegimet e subjektit dhe shkresat e administruara, trupi gjykues i Kolegjit pranon argumentet e subjektit të rivlerësimit në ankim se depozita bankare e çelur në vitin 2003 [me gjendje në fund të vitit në vlerën 709.149 lekë] kishte mundësi të krijohej me kursime të gjeneruara nga viti 1993 e deri në vitin 2002. Në këtë përfundim, trupi gjykues arrin duke pasur parasysh disa faktorë. Së pari, subjekti ka deklaruar depozitën bankare në shumën 730.108 lekë në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003, me burim krijimi kursimet nga paga dhe shpërblimet e tij dhe të bashkëshortes ndër vite. Ky deklaram është kryer në përputhje me detyrimet e tij sipas nenit 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, sipas të cilit të gjitha subjektet që mbartnin detyrimin për deklaram, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, detyroheshin të deklaronin të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre<sup>52</sup>. Së dyti, trupi gjykues ka parasysh konfirmimin e Bankës Raiffeisen [Dega {\*\*\*}]<sup>53</sup>, sipas të cilit bashkëshortja e subjektit ka pasur në datën 31.12.2003 një depozitë bankare në shumën 709.149 lekë. Së treti,

<sup>51</sup> Sipas analizës së Komisionit, vlerat negative për vitet 2005 dhe 2006 janë në total 173.107 lekë. Kjo shumë përbëhet nga diferenca negative prej respektivisht 167.945 lekë dhe 5.162 lekë për secilin vit. Shih faqen 21 të vendimit të Komisionit.

<sup>52</sup> Neni 6 i ligjit nr. 9049/2003 është shfuqizuar nga ligji nr. 9367/2005 (neni 50 – “Shfuqizimet”).

<sup>53</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 14.12.2018.

nga analiza financiare e kryer në Kolegj për periudhën para vitit 2003 dhe për vitin 2003, bazuar në deklarinimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin e administruar<sup>54</sup>, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kursimet e deklaruara dhe shpenzimet e kryera në vitin 2003, si dhe për blerjen e apartamentit në shumën 400.000 lekë për periudhën para vitit 2003. Për rrjedhojë, diferenca negative në vlerën 314.643 lekë, e përlllogaritur nga Komisioni në analizën financiare për vitin 2003, nuk është e saktë. Në përmbledhje, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të justifikuar kursimet e deklaruara para vitit 2003.

**32.2.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka konsideruar gabim, si likuiditet të pajustificuar, diferencën në vlerën 167.945 lekë për vitet 2005 – 2006, pasi banka ka kryer një gabim në momentin e maturimit të depozitës bankare [fundviti 2005], të cilin e ka korrigjuar vetë në fillim të vitit 2006, trupi gjykues i Kolegjit vëren se argumentimi i parashtruar për këtë pretendim nuk qëndron. Nga lëvizjet bankare konstatohet se veprimet korrigjuese nga banka janë kryer në fillim të vitit 2006, dhe prekin vetëm balancën e akumuluar në fund të vitit 2005. Si rrjedhojë, gjendja e akumuluar e likuiditeteve në bankë, më 31.12.2006, nuk ndryshon. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, u mor në konsideratë shtesa ose, sipas rastit, pakësimi i gjendjes së llogarive bankare gjatë vitit, që do të thotë diferenca midis gjendjes së likuiditeteve në fund të vitit kundrejt gjendjes së likuiditeteve në fillim të vitit. Nëse korrigjimi nga banka ndikon gjendjen në fund të vitit 2005, kjo do të thotë që me të njëjtën vlerë, por me kahe të kundërta do të ndryshojë diferenca e likuiditeteve 2005 – 2004 (që ndikon rezultatin financiar të vitit 2005) dhe diferenca e likuiditeteve 2006 – 2005 (që ndikon rezultatin financiar të vitit 2006). Për rrjedhojë, totali i rezultateve të dy viteve nuk ndryshon, por ndryshojnë vetëm rezultatet e viteve individualisht. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitet 2005 – 2006, rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera dhe kursimet për këto dy vite, duke rezultuar me diferenca pozitive në vlerën 33.392 lekë për vitin 2005 dhe në vlerën 92.668 lekë për vitin 2006.

**32.3.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni e ka konsideruar gabim diferencën në vlerën 699.231 lekë në vitin 2008 si likuiditet të pajustificuar, pasi kredia është shlyer nga babai i bashkëshortes – shtjelluar me hollësi në paragrafin 31.2 më sipër, si i papranueshëm në dritën e dokumentacionit që provon të kundërtën – trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe nëse abstragohet hipotetisht nga sa është shtjelluar në paragrafin 31.2 dhe pranohet versioni i fakteve të pretenduara nga subjekti, pretendimi gjithsesi nuk mbështetet nga analiza financiare. Konkretisht, analiza financiare e vitit 2007 për subjektin e rivlerësimit, edhe nëse pranohej hipotetisht që kredia e vitit 2007 është marrë për llogari të vjehrrit të subjektit dhe është shlyer prej këtij të fundit, do të rezultonte me rezultat negativ në vlerën 564.605,77 lekë. Ndërkohë, duke ndjekur arsyetimin e trupit gjykues të Kolegjit, analiza financiare që përfshin marrjen e kredisë në 2007 dhe shlyerjen e saj në vitin 2008 nga subjekti i rivlerësimit, siç rezulton nga dokumentacioni, tregon që ndërsa disbursimi i kredisë në vitin 2007 ka ndikuar pozitivisht analizën financiare për këtë vit (si hyrje *cash*-i), duke rezultuar me diferencë pozitive në vlerën 10.030,99 lekë, shlyerja e kredisë në vitin 2008 ka

---

<sup>54</sup> Në këtë analizë janë marrë në konsideratë: a) të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes sipas vërtetimeve nga institucionet dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore; b) të ardhurat nga shitblerjet e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme; c) shpenzimet e jetesës në nivelin 66% të të ardhurave për periudhën 1992-1999 dhe, sipas metodologjisë së referuar ILDKPKI-së nga INSTAT për periudhën 2000-2002; ç) deklarinimet e subjektit për sa i përket huadhënies të kompania {\*\*\*} dhe gjendjes së likuiditeteve. Balanca e depozitës më 31.12.2003 është konsideruar sa vlera e konfirmuar nga vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 14.12.2018, dërguar nga dega e Bankës Raiffeisen, {\*\*\*}, e cila është 709.149 lekë dhe jo 730.108 lekë, sikurse e ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003.

ndikuar negativisht në rezultatin financiar të vitit 2008 (si dalje *cash*-i), duke rezultuar me diferencë negative në vlerën 602812,51 lekë. Në konkluzion të kësaj analize financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në 2007 – sipas versionit të paraqitur prej tij – apo 2008 – sipas dokumentacionit mbi të cilin bazohet arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit në paragrafin 31.2 – ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së mbulimit të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme.

**32.4.** Në përfundim të analizës financiare për çdo vit që përfshihet në periudhën 2003 – 2016, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka pasur likuiditet të pajustificuar, pasi rezultojnë të pambuluara me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet vjetore të deklaruara, në shumën prej 602813 lekësh. Në këtë përlllogaritje nuk përfshihet pamundësia për dhënien e huas z. A.P. në shkurt 2015. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, janë *rivlerësuar* disa zëra të analizës financiare të kryer në Komisioni, sipas këtyre të dhënave: në analizën financiare të vitit 2005, interesi i fituar nga depozita është vendosur bruto nga ana e Komisionit, ndërsa në analizën e vitit 2006 është konsideruar si e ardhur nga interesi një nga veprimet e korrigjuara nga banka; përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës sipas metodologjisë së referuar ILDKPKI-së nga INSTAT ndër vite; në përlllogaritjen e gjendjes së llogarive bankare në fund të vitit është vendosur balanca sipas konfirmimit të bankës dhe jo sipas deklaramentit të subjektit; balanca prej 709.108 lekë është konsideruar kursim i viteve pararendës dhe jo vetëm i vitit 2003; gjendja *cash* në fund të vitit për vitin 2006 është vendosur sipas deklaramenteve të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 2.800.000 lekë. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e analizës financiare të kryer në Komision për periudhën 2003 – 2016 qëndrojnë pjesërisht. Për këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit rezulton me pamundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shumën 602813 lekë. Kjo përlllogaritje bazohet në gjendjen e fundviteve dhe është e pavarur nga pamundësia financiare për të mbuluar me burime të ligjshme huan që subjekti i ka dhënë z. A.P. në vitin 2015, shtjelluar me hollësi në paragrafin 30.4 më sipër.

**33.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me z. A.P., pasi marrëdhënia e huas është krijuar dy vite pas pushimit të çështjes penale për të cilën është vendosur pushimi i gjykimit, për shkak të heqjes dorë nga palët ndërgjyqëse dhe mosparaqitjes së tyre në gjykim.

**33.1.** Nga shqyrtimi i akteve, konstatohet se në çështjen gjyqësore<sup>55</sup> në fjalë, një nga të akuzuarit (i dëmtuar akuzues) ka qenë edhe z. A.P. Fillimisht [me vendimin e datës 21.05.2013], subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të çështjes ka vendosur bashkimin e çështjeve, duke qenë përpara dy çështjeve me akuza të ndërsjella ndërmjet palëve, për të njëjtën ngjarje. Në përfundim, është dhënë vendimi nr. {\*\*\*}, datë 04.06.2013, për pushimin e gjykimit të çështjes penale, pasi palët ndërgjyqëse hoqën dorë nga gjykimi. Huaja pa interes i është dhënë z. A.P. në datën 20.02.2015 (rreth 20 muaj pas dhënies së vendimit), në vlerën 1400000 lekë. Për pasojë, raporti kreditor/debitor nuk ekzistonte në periudhën maj – qershor 2013, kur subjekti i rivlerësimit është caktuar për të gjykuar çështjen në të cilën z. A.P. ishte palë. Nga dokumentacioni në fashikullin gjyqësor, nuk rezulton që ndonjë nga palët të ketë paraqitur kërkesë apo ankim për gjendje të konfliktit të interesit të gjyqtarit. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve, subjekti i rivlerësimit është shprehur se huaja është dhënë për shkak të lidhjeve shoqërore disavjeçare dhe që është fqinj me z. A.P.<sup>56</sup> Në ankim, subjekti argumenton se marrëdhënia shoqërore është krijuar pas gjykimit të çështjes, që nënkupton pas vitit 2013.

<sup>55</sup> Nr. {\*\*\*} regj. them., datë 07.05.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

<sup>56</sup> Përgjigjet e përcjella në rrugë elektronike më datë 04.10.2018.

**33.2.** Konflikti i interesit, sipas ligjit nr. 9367/2005, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike<sup>57</sup>. Një ndër rrethanat të cilat mund të dëshmojnë konfliktin e mundshëm të interesit, janë “marrëdhëniet e komunitetit” ose “marrëdhëniet e njohura të miqësisë”<sup>58</sup>.

**33.3.** Duke pasur parasysh që huaja është dhënë rreth 20 muaj pasi kishte pushuar gjykimi i çështjes, ekzistenca e ndonjë interesi të mundshëm pasuror mes subjektit dhe z. A.P., që të ndikojë apo të afektojë në shtimin e dyshimit të pasurisë për shkak të detyrës së subjektit, përjashtohet. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se për të përcaktuar nëse marrëdhënia e shoqërisë dhe e fqinjësisë përbën shkak njëanshmërie për gjyqtarin, do të duhet që paraprakisht të përcaktohet nëse raporti miqësor në vitin 2013 ka qenë në të njëjtën shkallë sikurse në vitin 2015. Së fundmi, në rast se do të rezultonte e provuar një marrëdhënie miqësie e ngushtë mes subjektit dhe huamarrësit palë në procesin gjyqësor, në mungesë të rrethanave që dëshmojnë interes pasuror të përfutur nga subjekti në kushtet e konfliktit të interesit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo lloj situatë do të duhej të trajtohej në kontekstin e integritetit, që është pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale. Në atë kontekst, mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi i çështjes kur gjyqtari është ose vihet në dijeni të rrethanave të cilat e bëjnë të detyrueshme dorëheqjen, përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor ndaj tij, sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nuk gjejnë zbatim kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, për sa i përket marrëdhënies së huadhënies mes subjektit të rivlerësimit dhe z. A.P.

**33.4.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ngatërron konceptet e “pushimit të gjykimit të një çështjeje” me “pushimin e çështjes”, “vendim i ndërmjetëm” me “vendim jopërfundimtar” apo “vendim përfundimtar”, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në rastin e konfliktit të interesit, nuk ka rëndësi mënyra e zgjidhjes së çështjes. Neni 17 i Kodit të Procedurës Penale, “Heqja dorë”, nuk bën dallime që lidhen me llojin e vendimit, por me faktin e heqjes dorë nga “gjykimi i çështjes konkrete” në rastin e ekzistencës së shtatë (7) rrethanave specifike, si dhe kur *ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie* (pika 1, germa “ë”). Shpjegimi dhe dallimi i kryer nga subjekti mes terminologjive të ndryshme, duket si rezultat i shpjegimit të përgjigjeve të kryera prej tij në hetimin administrativ, por nuk gjen mbështetje si koncept në procedurën penale ku ligjvënësi ka përdorur togfjalëshin “gjykimi i çështjes”. Logjika e parimit të përgjithshëm që përfshin “çdo gjykim”, duket qartë, po të kemi parasysh që në momentin kur një çështje shortohet, gjyqtari që detyrohet të ndërmarrë veprime sipas nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mund ta dijë objektivisht rrjedhën procedurale të çështjes dhe, për pasojë, e jep dorëheqjen detyrimisht sapo shortohet në një çështje ku me të paktën njërën nga palët gjendet në një nga rrethanat faktike të përshkruara në nenin 17 të këtij Kodi<sup>59</sup>, qoftë në formulimin e

<sup>57</sup> Neni 3, pika 1.

<sup>58</sup> Neni 5, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, përkatësisht germa “dh”, nënpikat “i” dhe “v”.

<sup>59</sup> Neni 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, sipas formulimit që ishte në fuqi në vitin 2013, parashikonte që: “1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit ose i fëmijëve të tij; b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij; c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërën prej palëve private; d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale; dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin

kohës apo atë të tanishëm. Nëse do të pranohej logjika e përdorur nga subjekti i rivlerësimit, neni 17 i Kodit do të përfshinte specifikime që lejonin gjyqtarët të jepnin dorëheqjen vetëm pasi një çështje e caktuar kalon në gjykim themeli. Rëndësia e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, është trajtuar gjerësisht edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>60</sup> dhe të GjEDNJ-së<sup>61</sup>. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

**33.5.** Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pjesërisht mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e shumës 1.400.000 lekë, të dhënë hua z. A.P. në vitin 2015, me një diferencë financiare të pajustificuar në vlerën 390.482 lekë, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar shpenzimet dhe pasuritë për periudhën 2003 – 2016, në shumën prej 602.813 lekësh, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

### Ç. Arsytimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës

- 34.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar kur e konsideruar kontakt të papërshtatshëm marrëdhënien me vëllanë e tij R.K. dhe kur ka konstatuar që subjekti mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale. Kontaktet më të vëllanë, të birin e tij, Sh.K., dhe me nipërit e tjerë janë bërë vetëm për arsye të lidhjes familjare. Këta familjarë të tij nuk mund të ndikojnë dhe të ushtrojnë presion mbi veprimtarinë e tij profesionale.

**34.1.** Nga dokumentacioni në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në deklaratën për kontrollin e figurës (Shtojca 3), të dorëzuar më datë 28.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të dhëna për nipin Sh.K., të akuzuar në Itali për trafikim të lëndëve narkotike, i cili së bashku me vëllanë R.K. janë akuzuar në Shqipëri për pastrim të produkteve të veprës penale. Kjo deklaratë e subjektit konfirmohet nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>62</sup>, sipas së cilës R. dhe Sh.K. janë proceduar nga kjo prokurori në vitin 2012, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, për të cilën në përfundim të hetimeve në datën 28.02.2014 është vendosur pushimi i saj. DSIK-ja me shkresën e datës 09.11.2018<sup>63</sup>, ka rishikuar raportin fillestar të datës 02.11.2017<sup>64</sup> dhe, duke ndryshuar konstatimin e mëparshëm, është shprehur për papërshtatshmëri të subjektit për vazhdimin e detyrës. Në raportin e grupit të punës së DSIK-së, të deklasifikuar pjesërisht<sup>65</sup>, citohet se nga ana e autoriteteve verifikuese janë informuar se për R.K. (vëllai i subjektit të rivlerësimit), Sh. dhe I.R.K. e K. dhe A.S.K. (nipërit e subjektit të rivlerësimit), disponohen të dhëna. Sipas raportit, ka informacione se R.K. me djemtë e tij dhe në bashkëpunim me kushërinjtë, janë të përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar. Ndërsa për nipin tjetër të subjektit të rivlerësimit, K.K., jepet informacion se është dënua me vendimin e datës 01.02.2012 nga

---

*procedim; e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie. 2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse”.*

<sup>60</sup> Shih vendimet nr. {\*\*\*}, datë 13.04.2007; nr. {\*\*\*}, datë 29.04.2010; nr. {\*\*\*}, datë 22.09.2011; nr. {\*\*\*}, datë 14.12.2017

<sup>61</sup> Shih Kyprianou k. Qipros [DhM]; Micallef k. Maltës [DhM]; Piersack k. Belgjikës; Hauschildt k. Danimarkës etj.

<sup>62</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.11.2018.

<sup>63</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., e përcjellë në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.11.2018.

<sup>64</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot.

<sup>65</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2018, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret”.



Gjykata e Apelit Tiranë, për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, ndërsa më datë 20.01.2017 ndaj tij ka filluar procedimi penal për veprën penale “Falsifikim i vulave, stampave ose formularëve”, të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.

**34.2.** Për sa rezulton nga dokumentacioni i përmendur më sipër, veprat penale për të cilat janë proceduar penalisht R. dhe Sh.K. — pastrimi i produkteve të veprave penale — i bënë këta dy individë të cilësohen “persona të përfshirë në krimin e organizuar” sipas përcaktimit të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, që u referohet veprave të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 10192/2009”). Nuk rezulton që këta dy individë të jenë shpallur të pafajshëm. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh që subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këta dy persona në formularin e kontrollit të figurës, duke dhënë edhe informacion të plotë mbi akuzat ndaj tyre, trupi gjykues i Kolegjit çmon se formulari për kontrollin e figurës është plotësuar me saktësi e vërtetësi nga ana e subjektit të rivlerësimit.

**34.3.** Nga ana tjetër, për sa u përket të dhënave për procedime apo hetim në lidhje me nipat e tjerë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se Komisioni me të drejtë ka arsyetuar se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për kontrollin e figurës kanë qenë të sakta dhe të vërteta. Veprat penale për të cilat janë akuzuar apo dënuar nipat e tjerë, përfshirë edhe K.K., nuk përfshihen në rrethin e veprave penale që lidhen me krimin e organizuar.

**34.4.** Trupi gjykues i Kolegjit, duke përdorur standardet për kontrollin e figurës të parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim kualifikimin e saktë të marrëdhënies që ka subjekti i rivlerësimit me vëllanë e tij si person i përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të nenit 3, pika 15 e këtij ligji, analizoi të gjitha faktet që kanë rezultuar nga hetimi administrativ dhe hedhin dritë mbi natyrën dhe afërsinë e këtij komunikimi dhe arriti në konkluzionin se ajo nuk është e tillë që të konsiderohet në zbatim të pikës 6 të nenit 3 dhe të pikës 4 të nenit 38 të ligjit, si një kontakt i papërshtatshëm që do të sillte si pasojë konsiderimin e subjektit të rivlerësimit si të papërshtatshëm për të kryer detyrën e gjyqtarit, sipas parashikimit të nenit 61, pika 2 e ligjit. Trupi gjykues vlerëson se marrëdhënia e afërt e gjakut që gjyqtari ka me personin e përfshirë në krimin e organizuar, është një rrethanë që nuk varet prej tij apo zgjedhjeve të tij, për pasojë, është sjellja dhe qasja e gjyqtarit në drejtim të ridimensionimit apo përshtatjes së kësaj marrëdhënieje, duke ditur faktin se ndaj tij është ushtruar ndjekja penale për një aktivitet kriminal të dyshuar, që penalizon dhe dëmton figurën e gjyqtarit në kryerjen e funksioneve të tij, ajo që duhet të vlerësohet dhe të arsyetohet më së shumti në këto raste.

Në këtë kontekst, nga hetimi administrativ nuk rezulton ndonjë e dhënë që tregon për komunikime të shpeshta apo të afërta mes subjektit dhe vëllait të tij, për më tepër komunikime që interferojnë apo lidhen me detyrën e subjektit. Vetëm fakti që djali i tij ka frekuentuar shtëpinë e vëllait të subjektit gjatë kohës kur ndiqte studimet në Tiranë, duke pasur në konsideratë kulturën dhe zakonet e vendit tonë, si edhe nevojën dhe rrethanat në të cilat gjendet një i ri në një qytet në të cilin nuk banon familja e tij, e çojnë Kolegjin në përfundimin se kjo marrëdhënie nuk është e tillë që të konsiderohet se krijon një kontakt të papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të ligjit.

**34.5.** Trupi gjykues gjithashtu mban në konsideratë se subjekti i rivlerësimit ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me deklarin e kontaktit me vëllanë R.K., gjatë plotësimit të formularit për kontrollin e figurës. Po ashtu, gjatë procesit të rivlerësimit nuk janë administruar prova nga të cilat të rezultojë se ai mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale. Nën dritën e këtij vlerësimi, trupi gjykues i Kolegjit çmon, në kushtet

kur ekzistojnë dy nga kushtet e parashikuara nga neni 38, pika 5, germet “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, të cilat konsiderohen si rrethana lehtësuese në standardet e përdorura për të vlerësuar kriterin e figurës në procesin e rivlerësimit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka kontakte të papërshtatshme në kuptim e zbatim të kriterëve të përcaktuara prej ligjit në vlerësimin e figurës. Për pasojë, ndaj tij nuk mund të zbatohet vendosja e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për shkak të pasjes së këtij kontakti, sipas parashikimit të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Megjithatë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se fakti që vëllai i subjektit të rivlerësimit është proceduar penalisht për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprave penale, si edhe konsiderimi i faktit që nipërit e tij janë përfshirë në veprimtari kriminale, që pavarësisht se nuk përfshihen në rrethin e krimit të organizuar<sup>66</sup>, duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata të cilat mund afektojnë drejtpërdrejt cenimin e besimit të publikut të subjekti i rivlerësimit, si pjesë e sistemit të drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**34.6.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se raporti i DSIK-së është i pasaktë, në kundërshtim me ligjin dhe se është i diktuar nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim mbetet i paprovuar, në kushtet kur raporti i grupit të punës së DSIK-së është hartuar bazuar në informacionin e përcjellë nga autoritetet verifikuese dhe të pavarura ndërmjet tyre. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni, pavarësisht konstatimeve të grupit të punës së DSIK-së, ka kryer hetim dhe rivlerësim të provave të mbledhura dhe të informacioneve konfidenciale të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, mbi rezultatet e të cilave i ka kaluar edhe barrën e provës subjektit të rivlerësimit dhe në përfundim ka arsyetuar dhe konkluduar mbi gjetjet për këtë kriter.

**34.7.** Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues i Kolegjit vëren se analiza dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë kriter nuk është në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nuk mbështetet në fakte e rrethana që justifikojnë konstatimin si kontakt të papërshtatshëm të marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me vëllanë e tij, të përfshirë në krimin e organizuar, sikurse përcakton ligji nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit, në ndryshim nga Komisioni, arrin në përfundimin se të gjitha rrethanat e përshkruara më lart janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm që u bëhet të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit për subjektin Izet Kadana, të cilat së bashku më të dhënat e tjera të cituara në arsyetimin e këtij vendimi, konkludohet se cenojnë besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe përcaktojnë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

*D. Arsyetimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit profesional*

35. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje se nga raporti i KLD-së është vlerësuar pozitivisht në kriterin e aftësisë profesionale, aftësisë organizative, etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, dhe aftësisë personale dhe angazhimit profesional që problemet e konstatuara në

<sup>66</sup> Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë informon Komisionin se ndaj R.K., në vitin 2011 është regjistruar kallëzimi penal me nr. {\*\*\*}, për veprën penale të parashikuar nga neni 186/2, 3 i K.Penal (“Falsifikimi i dokumenteve”) dhe në datën 18.02.2011 është vendosur mosfillimi i hetimeve; ndaj Sh. dhe F.K. në vitin 2011 është regjistruar kallëzimi penal nr. {\*\*\*}, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 277 (“Vetëgjyqësia”) dhe 90/2 (“Dëmtime të tjera me dashje”) të K.Penal dhe në datën 26.12.2011 është vendosur mosfillimi i hetimeve; ndaj I.K. në vitin 2011 është regjistruar kallëzimi penal nr. {\*\*\*} për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 143 (“Mashtrimet”) të K.Penal dhe në datën 20.05.2011 është vendosur mosfillimi i hetimeve. Ministria e Drejtësisë së Italisë ka përcjellë të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të I.R.K./I.R.L./A.R.K./A.R.L., ndaj të cilat janë dhënë dy vendime, një në vitin 2010 dhe tjetri në vitin 2012, për falsifikim dokumentacioni.

dosjet e vëzhguara kanë qenë për shkaqe objektive dhe arsye të përligjura. Sistemimi i dosjeve nuk është detyrë funksionale e gjyqtarit, dhe të gjitha vendimet objekt hetimi kanë marrë formë të prerë. Subjekti i rivlerësimit parashtron se lidhur me ankesën e znj. F.L. ka dhënë shpjegime në IKLD, dhe për këtë çështje i është tërhequr vëmendja me shkrim. Ai pranon se ishte një gabim i tij në komunikim, për shkak të marrëdhënieve shoqërore. Nuk është e vërtetë që ai ka ndikuar në emërimin e bashkëshortes pasi nuk ka njohje, lidhje apo komunikim me asnjë nga personat që e kanë emëruar.

**35.1.** Nga aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka konstatuar të njëjtat mangësi si ato të vëna në dukje nga KLD-ja<sup>67</sup>. Lidhur me gjetjet e raportit të KLD-së, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime, lidhur me mangësitë e evidentuara në dosjet e shortuara, etikën në komunikimin me sms me znj. L, si dhe me ndikimin e mundshëm të tij në emërimin e bashkëshortes. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale janë parashtruar edhe në ankim.

**35.2.** Parregullsitë e konstatuara nga analiza e 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short dhe nga informacioni i marrë nga KLD-ja, lidhen me aftësitë organizative, si dhe me etikën e angazhimit ndaj vlerave profesionale. Këto mangësi përmbledhen si në vijim: në dy raste, kohëzgjatja e gjyqësorisë ka qenë përtej afatit ligjor; në tri raste, dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë depozituar përtej afatit ligjor; në një rast mungon dokumentimi i dy seancave gjyqësore; në dy raste dosja gjyqësore nuk është e sistemuar në mënyrë kronologjike, pasi janë administruar më parë konkluzionet përfundimtare të palëve e më pas procesverbalet gjyqësore; në katër raste, në pjesën arsyetuese të vendimit nuk është përdorur shprehimisht ndonjë parim i përgjithshëm i së drejtës dhe në dy raste nuk janë marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes brenda afatit. Së fundmi, në vitin 2015 është verifikuar një ankesë për etikën në komunikim të subjektit të rivlerësimit – konkretisht për dërgimin e disa sms-ve – që nuk kishin të bënin me detyrën e gjyqtarit, dhe në përfundim të verifikimeve është sugjeruar dhe aplikuar tërheqje vëmendjeje me shkrim, si dhe shënim për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

**35.3.** Vlerësimi i aftësive profesionale për gjyqtarët përfshin aftësitë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligjin nr. 96/2016. Sipas nenit 74 të këtij ligji, kriteri i aftësisë organizative vlerësohet në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës, për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.

**35.4.** Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim dhe të mangësive të evidentuara në lidhje me vlerësimin profesional të tij, në raportin e KLD-së dhe në vlerësimin e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, mbështetur në standardet e përcaktuara në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit për secilin rast të trajtuar duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkeljen e afateve të gjykimit të çështjes, të dorëzimit të dosjeve dhe të dorëzimit të vendimeve të arsyetuara; duhet të verifikonte dosjet gjyqësore me qëllim plotësimin, përfshirjen dhe sistemimin e tyre me aktet e plota dhe të renditura sipas kronologjisë së veprimeve procedurale të ndërmarra gjatë procesit, si dhe duhet të kryente veprimet procedurale brenda afateve ligjore me qëllim menaxhimin efektiv të procesit gjyqësor.

---

<sup>67</sup> Shih faqen 30 të vendimit.

**35.5.** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nga raporti i KLD-së është vlerësuar pozitivisht në të katërta kriteret e vlerësimit profesional, nuk qëndron. Mangësitë e vlerësuar nga Komisioni janë të njëjta me ato të vëna në dukje edhe në raportin e KLD-së. Raporti i këtij të fundit përmban vetëm analizën ligjore të 8 dokumenteve ligjore të përpiluara prej subjektit të gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, 3 të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe 5 të përzgjedhura në mënyrë rastësore, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016.

**35.6.** Lidhur me pretendimin se vendimet në fjalë kanë marrë formë të prerë, pasi nuk janë ankimuar ose janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se lënia ose jo në fuqi e vendimeve të dhëna nga subjektet e rivlerësimit është argument me vlerë, por jo në vlerësimin profesional të subjekteve. Në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 96/2016, vlerësimi profesional analizon aftësitë profesionale të një gjyqtari nga një këndvështrim relativisht teknik, i cili nuk gjykon korrektesinë e vendimit dhe në asnjë rast themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet. Në këtë kontekst, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pavarësisht mangësive të konstatuara në drejtim të aftësive organizative, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në tri kriteret e vlerësimit profesional, bazuar në nenet 72, 74 dhe 76 të ligjit nr. 96/2016, pasi ka aftësi të mira profesionale, aftësi të mjaftueshme organizative, si dhe aftësi personale e angazhim profesional.

**35.7.** Për sa i përket ankesës nga znj. F.L., në sqarimet e dhëna në ankim subjekti ka pranuar se ka qenë një gabim i tij në komunikim, që nuk ishte për shkaqe të detyrës, por si rrjedhojë e njohjes dhe e marrëdhënies shoqërore. Në konkluzion të atij procesi, për komunikim joetik jashtëgjyqësor, subjektit të rivlerësimit i është tërhequr vëmendja me shkrim nga IKLD-ja, duke e bërë pjesë të dosjes së vlerësimit dhe të përdorshme vetëm në rastin e vlerësimit profesional dhe etik të tij.

**35.7.1.** Në përmbajtje të ankesës së znj. F.L., depozituar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë në vitin 2015, pjesë e fashikullit të përcjellë në Kolegj, janë riprodhuar 19 sms që i përkasin datës 06.03.2015. Kjo periudhë përkon me kohën kur subjekti i rivlerësimit ka mësuar se znj. L. ishte një nga konkurrentet e bashkëshortes së tij për pozicionin e kryesekretares në Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Në përfundim të verifikimit të fakteve të pretenduara në ankesë, IKLD-ja ka ndërmarrë nismën e shtjelluar në paragrafin 35.7. Gjetjet e verifikimit mbi këtë ankesë, KLD-ja i ka përfshirë në analizën e raportit të përgatitur për procesin e rivlerësimit për kriterin që lidhet me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit dhe në shqyrtimin përfundimtar, këtë çështje e ka trajtuar në kuadër të vlerësimit të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, bazuar në nenin 75 të ligjit nr. 96/2016.

**35.7.2.** Në konkluzion, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka përdorur fjalë dhe ka reflektuar sjellje që vijnë në kundërshtim me etikën e një gjyqtari gjatë komunikimit me mesazhe me znj. F.L., ka përfituar një favor për shkak të detyrës duke përdorur pozitën, pasi ka kryer veprime që tregojnë në mënyrë direkte ose indirekte ndikimin e tij për emërimin në punë të bashkëshortes së tij. Po ashtu, Komisioni ka konkluduar edhe për situatë të konfliktit të interesit në shqyrtimin e çështjes me A.P.

**35.7.3.** Trupi gjykues i Kolegjit, në rrethanat faktike konkrete, vëren se subjekti i rivlerësimit, teksa gëzonte funksionin e magjistratit, i ka dërguar 19 mesazhe telefonike një bashkëqytetareje konkurrente të bashkëshortes së tij për një vend pune. Znj. L. ishte në dijeni të funksionit që kryente subjekti i rivlerësimit. Mesazhet e shumta të dërguara prej tij, brenda një harku kohor prej më pak se 24 orësh, në mënyrë të vazhdueshme, me një përmbajtje që

kishte për qëllim të siguronte marrësen për faktin që dërguesi, një person me influencë, ishte i pezmatuar nga konkurrimi i saj për vendin e punës. Subjekti i kujton marrëses se do i jepej mundësia të konstatonte pushtetin e dërguesit – subjektit të rivlerësimit. Sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me sjelljen që pritet të ketë një gjyqtar dhe që nuk është në përputhje me parimet e Bangalores<sup>68</sup>, pavarësisht justifikimit të tij se kjo lloj sjelljeje lidhet me marrëdhëniet shoqërore ndërmjet tyre. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se gjyqtarët kanë përgjegjësinë që edhe në jetën jashtëgjyqësore të jenë të vëmendshëm për të mos cenuar autoritetin e pushtetit gjyqësor, sjellje këto që afektojnë drejtpërdrejt besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Veprimet jashtëgjyqësore të gjyqtarëve duhet të jenë të atilla që mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tyre, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore dhe se nuk mundet ta përdorin autoritetin e statusit të tyre për të arritur, përmbushur interesat e tyre ose të tjerëve dhe as nuk duhet të krijojnë ose të lejojnë të tjerët të krijojnë përshtypjen se ata gjenden në një pozitë të veçantë për të ndikuar mbi të<sup>69</sup>. Duke mbajtur në konsideratë përmbajtjen dhe rrethanat e komunikimit, në funksion të qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se veprimet e subjektit të rivlerësimit përbëjnë sjellje që nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit gjatë komunikimit me znj. F.L. ka reflektuar sjellje të cilat nuk përputhen me etikën dhe sjelljen jashtëgjyqësore që një gjyqtar pritet të ketë dhe krijon kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**35.7.4.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni hamendëson lidhur me punësimin e bashkëshortes së tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, pasi ai nuk ka pasur asnjë njohje, lidhje apo komunikim me asnjë nga personat që e kanë emëruar atë, trupi gjykues i Kolegjit analizoi kronologjinë kohore të ngjarjeve që lidhen me procedurat e ndjekura për emërimin e bashkëshortes së tij dhe të verifikimeve të kryera në kuadër të shqyrtimit të ankesës së znj. F.L. Nga kjo analizë rezulton se më datë 25.02.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme për procedurat e emërimit të kryesekretarit, duke evidentuar tri kandidatura, përfshirë denoncuesen dhe bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit; më datë 27.02.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë ka përcjellë pranë Prokurorisë së Përgjithshme praktikën e punësimit për plotësimin e vendit vakant; më datë 05.03.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë ka kërkuar dhënien e pëlqimit nga Prokurori i Përgjithshëm për emërimin e kandidatit të propozuar në këtë detyrë (pa cituar emrin e kandidatit të propozuar). Një ditë më vonë ka ndodhur komunikimi mes subjektit dhe znj. L, pra më datë 06.03.2015. Më datë 19.03.2015, Prokurori i Përgjithshëm ka dhënë pëlqimin për emërimin e znj. K. në detyrën e kryesekretares. Prokuroria e Përgjithshme më datë 19.11.2018<sup>70</sup> informon Komisionin se nuk ka pasur dijeni se znj. S.K. është bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, dhe ka bashkëlidhur aktet e sipërcituara, përfshirë edhe dokumentacionin e dorëzuar për aplikim të znj. S.K.

<sup>68</sup> *Parimet e Bangalores të vitit 2002 përcaktuan një sërë "vlerash", ku përfshihej edhe integriteti, të cilit duhet t'i përmbahen të gjithë gjyqtarët. Këto parime theksojnë se gjyqtari duhet të sigurojë që sjellja e tij të jetë e paqortueshme nga këndvështrimi i një vëzhguesi të arsyeshëm dhe mënyra e sjelljes duhet të ripohojë besimin e njerëzve tek integriteti i gjyqësorit. Parimet e Bangalores për sjelljen gjyqësore, 2002:*

[http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial\\_group/Bangalore\\_principles.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf) – miratuar nga Kombet e Bashkuara me rezolutën 2006/23.

<sup>69</sup> *Shih rregullat 15 dhe 19 të Kodit të Etikës, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare më 08.12.2006.*

[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi\\_i\\_etikes\\_gjyqesore\\_1754.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf).

<sup>70</sup> *Shkresa nr. {\*\*\*} prot.*

35.7.5. Nga ana tjetër, nëse i referohemi procesverbalit të mbajtur nga inspektorët e IKLD-së gjatë procesit të verifikimit të ankesës së znj. L., subjekti i rivlerësimit është shprehur se ka pyetur prokurorin e rrethit mbi kandidaturën e bashkëshortes së tij dhe mbi personat e përzgjedhur, dhe është informuar se bashkëshortja e tij nuk ishte propozuar dhe se personat e përzgjedhur ishin dy persona të tjerë, ndër të cilët edhe denoncuesja. Atë ditë, ai i kishte dërguar mesazhet znj. L. dhe pas pak ditësh, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është kërkuar edhe dosja e bashkëshortes së tij. Në dritën e rrjedhës kronologjike të shtjelluar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, së pari, argumentimi i subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka pasur asnjë njohje, lidhje apo komunikim me asnjë nga personat që e kanë emëruar bashkëshorten e tij nuk është bindës dhe i sigurtë, pasi ai vetë pranon lidhje dhe komunikim me prokurorin e rrethit. Së dyti, subjekti ka zgjedhur të përziejë rrjedhën kronologjike në përpjekje për të lehtësuar vetveten në komunikim, pasi komunikimi me denoncuesen nëpërmjet 19 sms-ve ka ndodhur një ditë pas dërgimit të kërkesës për dhënien e pëlqimit për emërimin e kandidatit. Nga fashikulli i administruar, rezulton të mos ketë pasur korrespondencë të mëtejshme shkresore mes Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë nga data 5 mars 2015 deri më 19 mars 2015 – kjo e fundit data kur është dhënë pëlqimi për emërimin e znj. K. nga Prokurori i Përgjithshëm. Në rrethanat e analizuara, për shkak edhe të paqartësisë së akteve të administruara, ndikimi i drejtpërdrejtë i subjektit të rivlerësimit në emërimin e bashkëshortes së tij në pozicionin e kryesekretares në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë mbetet në nivel indicieje, i paprovuar plotësisht.

36. Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues i Kolegjit vëren se zbatimi i prezumimit në favor të masës disiplinore, bazuar në nenin E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka treguar sjellje të papërshtatshme, nuk është bindës. Konkretisht, Komisioni në rezultatet përfundimtare të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, shprehet se edhe pse subjekti ka arritur nivel kualifikues për kriterin e aftësive profesionale, aftësive organizative, aftësive personale dhe angazhimin profesional, cenimi i etikës në komunikimin me znj. F.L., qëndrimet dhe ndikimi i tij në lidhje me emërimin në detyrë të bashkëshortes së tij, ndikojnë drejtpërdrejt në cenimin e besimit të publikut te subjekti i rivlerësimit, si pjesë e sistemit të drejtësisë.
37. Sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, qëllimi i rivlerësimit të aftësive profesionale është të identifikojë magjistratët që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Në qasje me qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, trupi gjykues i Kolegjit thekson se është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, trajtuar edhe në opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias<sup>71</sup>. Trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur edhe në jurisprudencën e deritanishme të tij<sup>72</sup>, vlerëson se kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016.
38. Subjekti i rivlerësimit, sikurse i rezultoi edhe Komisionit, ka treguar nivel kualifikues në tri nga katër kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale. Pavarësisht nga ky konstatim, me sjelljen e tij kundrejt denoncueses ka zgjedhur një qëndrim që krijon kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia. Trupi gjykues i Kolegjit, në zbatim të përcaktimit të etikës

<sup>71</sup> Shih paragrafin 35 të opinionit CDL-AD (2016)036.

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

<sup>72</sup> Shih vendimin nr. 21, datë 13.09.2019, të Kolegjit, <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/11/Vendimi-G-Medja-i-anonimizuar-per-web.pdf>.

dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale nga një gjyqtar apo prokuror sipas nenit 71 të ligjit nr. 96/2016<sup>73</sup>, si kritere në vlerësimin e magjistratëve, vëren se shkelja e etikës jashtëgjyqësore, qoftë kjo edhe në kontekstin e një situatë të diskutueshme të marrëdhënieve shoqërore, e lidhur edhe me rezultatet e tri kritereve të tjera të aftësive profesionale, nuk dikton mjaftueshëm peshë dhe nuk përmbush standardin për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit, në ndryshim nga Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e zbatimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi në komunikimin e nisur në datën 06.03.2015 me znj. L, konkurrente e bashkëshortes së tij për një vend pune, duke u shprehur me tone kërcënuese dhe shantazhuese se do të ndikonte nëpërmjet pozitës së tij në punësimin e bashkëshortes, ka reflektuar qëndrim që krijon kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia.

*Dh. Konkluzione përfundimtare*

39. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi të gjitha aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe shqyrtoi vendimin nr. 92, datë 20.12.2018, të Komisionit mbi bazën e shkaqeve të ankimit, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, konstatoi se:

**39.1. në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë:**

- i. subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e shumës që ka shërbyer për dhënie të huas pa interes në shumën 1400000 lekë z. A.P. në vitin 2015, në vlerën negative prej 390482 lekësh, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016;
- ii. nga analiza financiare e kryer në Kolegj për periudhën 2003 – 2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar shpenzimet dhe pasuritë në shumën prej 602813 lekësh, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**39.2. në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës,** subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia për shkak të komunikimeve të rregullta dhe të vazhdueshme me një person të proceduar penalisht për vepra të përfshira në krimin e organizuar [vëllanë]. Parë në tërësi dhe njëkohësisht me sa më sipër, informacionet për veprimtari kriminale që lidhen me familjarë të tjerë të tij të shkallës së tretë [nipër], edhe pse nuk përbëjnë shkak ligjor për vlerësim negativ të kriterit të figurës, vlerësohen nga trupi gjykues se së bashku përfaqësojnë një situatë faktike që cenon besimin e publikut te subjekti i rivlerësimit si pjesë e sistemit të drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**39.3. në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale,** në komunikimin e nisur në datën 06.03.2015 me znj. L., konkurrente e bashkëshortes së tij për një vend pune, duke u shprehur me tone kërcënuese dhe shantazhuese se do të ndikonte nëpërmjet pozitës së tij në punësimin e bashkëshortes, ka reflektuar qëndrim që krijon kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>73</sup> “Vlerësimi kryhet sipas kritereve të mëposhtme: a) aftësive profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; b) aftësive organizative; c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.”

40. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe me sjelljet dhe veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
41. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, pasi e gjykoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet 49 e 55 të ligjit nr. 49/2012, vlerëson se vendimi nr. 92, datë 20.12.2018, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 92, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Izet Kadana.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 04.03.2020.

**ANËTAR**

**Luan DACI**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Ardian Hajdari**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*



## MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtarët Ina Rama dhe Sokol Çomo, kemi votuar pro qëndrimit të mbajtur në vendimin e trupit gjykues për sa i përket pjesës më të madhe të argumenteve të arsyetuara në vendim dhe që legjitimojnë lënien në fuqi të vendimit nr. 92, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Izet Kadana, duke mbajtur qëndrimin se si bazë ligjore e vetme për shkarkimin e tij nga detyra duhej të përdorej neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dhe kemi votuar kundër qëndrimit të mbajtur në vendim se subjekti gjendet edhe në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e tij, në zbatim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
2. Ky qëndrim, ndonëse nuk afekton vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), lidhet me një arsyetim të ndryshëm rreth vlerësimit të vlerës së të ardhurave të rezultuara me mungesë burimi të ligjshëm për subjektin e rivlerësimit, për të cilën ne çmojmë se duhet aplikuar parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, sipas parashikimit të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Ky arsyetim mbështetet mbi disa fakte që kanë rezultuar nga gjykimi në Kolegj, të cilat shtjellohen më poshtë.
  - 2.1 Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, duke përdorur të dhënat që vijnë nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe duke reflektuar në këtë analizë ato pretendime të parashtruara prej subjektit në ankimin e tij e që janë gjetur të drejta nga trupi gjykues, rezulton se ai paraqitet me një gjendje financiare negative dhe në pamundësi për të financuar plotësisht huan e dhënë shtetasit A.P. në datën 20.02.2015, për një vlerë prej 390.482 lekësh.<sup>74</sup>
  - 2.2 Gjithashtu, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është gjendur me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të përballuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në vitin 2007 në vlerën prej 564.605,77 lekë, në versionin e pretenduar prej tij, për marrjen e kredisë nga bashkëshortja prej 700.000 lekësh nga Banka Raiffeisen, për llogari të babait të saj në vitin 2007 kredi e cila është shlyer nga babai; dhe me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për vitin 2008 në vlerën prej 602.812,51 lekë në versionin e pranuar prej Komisionit të Kolegjit se kredia prej 700.000 lekësh është marrë në vitin 2007 prej bashkëshortes së subjektit për llogari të saj dhe është shlyer po prej saj.<sup>75</sup>
3. Në lidhje me këtë qëndrim të trupit gjykues, kemi ndarë mendim të ndryshëm, duke pranuar si të provuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kredia e marrë prej bashkëshortes së tij nga Banka Raiffeisen në vitin 2007, është marrë për llogari të babait të saj dhe është shlyer po prej tij në vitin 2008.
4. Për të arritur në këtë konkluzion, kemi arsyetuar duke analizuar të dhënat e përfutuara prej provave të administruara përgjatë hetimit administrativ, të cilat, të vlerësuara në harmoni me

<sup>74</sup> Shih paragrafët 30.4, 31.3 të vendimit të arsyetuar.

<sup>75</sup> Shih paragrafët 31.2 e 32.3 të vendimit të arsyetuar.

njëra-tjetrën dhe të çmuara në raport me vlerën provuese të secilës, si pjesë integrale e një vlerësimi e gjykimi të mbështetur edhe në bindjen e brendshme, na kanë çuar në konkluzionin se pretendimi i subjektit është i bazuar.

5. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën e detyrimeve ndaj personave juridikë dhe fizikë, marrjen në vitin 2007 dhe shlyerjen në vitin 2008 të një kredie prej 700.000 lekësh në Bankën Raiffeissen. Në këtë deklaram ai ka shpjeguar se kjo kredi është marrë prej bashkëshortes së tij për llogari të vjehrrit të tij dhe është shlyer po prej tij. Në drejtim të verifikimit të vërtetësisë së këtij deklarimi, konstatohet se edhe në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë kredinë e marrë prej bashkëshortes së tij në këtë vit me të dhënat përkatëse, duke e shoqëruar me shënimin: *kredia e sipërpërmendur është marrë nga bashkëshortja ime S.K., me qëllim për të ndihmuar biznesin e babait të saj, H.M., dhe që shlyhet rregullisht në mirëbesim nga ana e tyre*. Në mbështetje të këtij deklarimi të kryer në deklaratën periodike, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka dhënë shpjegime në përgjigjet e kthyera për pyetëtorin e datës 02.11.2018, si dhe në shpjegimet e dhëna pas njohjes me rezultatet paraprake të hetimit, datë 17.12.2018, duke shpjeguar se babai i bashkëshortes, i ndjeri H. M. ka pasur një aktivitet tregtar “furrë buke” dhe bashkëshortja e tij i është ofruar ta ndihmojë meqenëse ajo ishte punonjëse e Bankës Raiffeissen dhe mund të merrte kredi me interesa më të ulëta, pa i kërkuar ndihmë subjektit për të përdorur për dhënien e huas paratë që ai vetë dispononte *cash* në banesë. Të njëjtat fakte deklaroi edhe vëllai dhe nëna e bashkëshortes, përkatësisht B.M. në deklaratën noteriale të datës 05.11.2018 dhe Z. M. në deklaratën noteriale të datës 12.12.2018. Fakti i pretenduar për aktivitetin e të ndjerit provohet edhe nga vërtetimi i lëshuar prej Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas të cilit shtetasi H.M. ka pasur një aktivitet privat të regjistruar në organet përkatëse, sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 25.07.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë nga hetimi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që subjekti i rivlerësimit ta ketë shpenzuar shumën e marrë kredi në asnjë formë apo ta ketë investuar në ndonjë aktivitet të caktuar që do të përlligjte marrjen e kredisë dhe pagimin e interesave.
6. Në këto rrethana, rezulton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* në lidhje me këtë kredi mbështet nga vlera provuese e asaj çfarë përshkruhet në deklaratën periodike, e marrë si provë në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet dhe harmonizohet me vetë shpjegimet e subjektit dhe deklaramet e shtetasve B.M. e Z.M., deklarime të cilat janë një nga llojet e burimit të provës sipas parashikimeve të nenit 49, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për më tepër, marrin të njëjtin kuptim logjik nga indicia se, për sa kohë nuk rezulton që subjekti ta ketë përdorur këtë shumë për ndonjë shpenzim apo pasuri të familjes së tij, deklarimi i tij mbi destinacionin dhe shlyerjen e kredisë është i saktë dhe i vërtetë.
7. Gjithashtu në vlerësimin tonë, vërejmë se edhe në terma financiarë, për llogari të analizës financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, pranimi si të vërteta i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk prodhon ndonjë ndryshim të rëndësishëm në analizën e tij financiare, krahasuar me rezultatin që ka analiza sipas versionit që ka pranuar Komisioni dhe shumica në Kolegj, se kjo kredi është marrë dhe shlyer nga bashkëshortja e subjektit për nevojat e saj.

8. Duke krahasuar këto dy qëndrime në raport me rezultatin e analizës financiare, rezulton se ndërsa në versionin e pretenduar prej subjektit, kjo shumë prej 700.000 lekësh e marrë kredi, nuk do të llogaritet si e ardhur e tij për vitin 2007 (viti i disbursimit të kredisë) dhe as si shpenzim për vitin 2008 (viti i shlyerjes së kredisë), në versionin e pranuar prej Komisionit dhe shumicës së trupit gjykues në Kolegj, do të konsiderohej si e ardhur në vitin 2007 dhe si shpenzim në vitin 2008, duke prodhuar në terma financiarë vetëm spostimin e balancës negative për subjektin e rivlerësimit nga viti 2007 në vitin 2008, me një diferencë të pandjeshme në masën e saj në versionin e pretenduar prej subjektit. Në versionin e pretenduar prej subjektit, balanca negative evidentohet në analizën financiare të vitit 2007 në vlerën prej 564.605,77 lekësh dhe në versionin e pranuar nga Komisioni dhe shumica e trupit gjykues, balanca negative do të evidentohet në vitin 2008 për vlerën 602.812,51 lekë<sup>76</sup>.
9. Në vijim të këtij arsytimi, kemi konkluduar se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për këtë çështje është i drejtë dhe, për pasojë, në arsyetimin tonë do të konsiderojmë se vlera totale që përfaqëson balancën negative për subjektin e rivlerësimit do të përbëhet nga vlera prej 564.605,77 lekësh për vitin 2007 dhe vlera prej 390.482 lekësh, që përfaqëson mungesën e burimeve financiare për të mundësuar dhënien e huas shtetasit A.P. në vitin 2015, të cilat në total janë gjithsej 955.087 lekë.
10. Duke vlerësuar këtë shumë që tregon mungesën e burimeve të ligjshme të të ardhurave për subjektin e rivlerësimit përgjatë gjithë karrierës së tij (prej 24 vitesh punë në sistemin e drejtësisë), faktin që analiza financiare mbetet një instrument që tenton t'i afrohet në mënyrë të arsyeshme realitetit të shpenzimeve e pasurive të vëna nga subjektet e rivlerësimit, por që mbetet kryesisht një vlerësim me doza subjektiviteti, për sa kohë që jo çdo e dhënë e përdorur për kryerjen e saj është e mbështetur mbi dokumentacionin korrespondues, shpenzimet e jetesës sipas përcaktimeve të INSTAT për vitin 2007 (në të cilin rezulton për subjektin edhe balanca negative më e lartë) kanë një rritje të paarsyeshme krahasuar me vitet e tjera pararendëse, por edhe pasrendëse, e cila bëhet edhe më jorealiste për shkak të jetesës në një qytet të vogël e periferik si Puka, ku kostoja e jetesës natyrshëm është më e ulët se në vende të tjera më të zhvilluara të vendit, vlerësojmë se legjitimon Gjykatën të ushtrojë diskrecionin e saj për të përcaktuar, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nëse një balancë e caktuar negative mundet të përbëjë shkak të mjaftueshëm për të konkluduar për *shpjegimin bindshëm të burimit të ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave* të subjektit të rivlerësimit, sipas standardit kushtetues të parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
11. Në këtë kuptim, kemi vlerësuar se nëse Kolegji do të gjendej vetëm para kësaj balance negative, e pashoqëruar me shkaqe të tjera që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë, nuk do të duhej të gjente vend zbatimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk do të ishte proporcionale të konsiderohej pikërisht kjo shumë si mungesë të ardhurash me burim të ligjshëm, që e çon subjektin drejt zbatimit të masës disiplinore të shkarkimit.
12. Pavarësisht këtij qëndrimi që lidhet me zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kemi çmuar se mungesa e burimit të ligjshëm të të ardhurave në këtë masë duhej të bëhej pjesë e

---

<sup>76</sup> Shih paragrafin 32.3 të vendimit të arsytuar.

vlerësimit tërësor dhe të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit, në zbatim të parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe duhej të analizohej bashkë me problematikat e tjera të konstatuara nga kontrolli i kriterit të figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

13. Në vlerësimin tonë, në kuadër të kësaj analize, kjo mungesë e burimit të ligjshëm të të ardhurave (në vlerën prej 955.087 lekësh) është një element plotësues, që të krijon mundësinë e një vlerësimi të përgjithshëm për këtë subjekt rivlerësimi dhe të mundëson matjen potenciale të cenimit të besimit të publikut te ky individ, si një funksionar i drejtësisë.
14. Nga ky këndvështrim, ky element që lidhet me kontrollin e kriterit të pasurisë, i analizuar bashkë me shkaqet e tjera që lidhen me kontrollin e kriterit të figurës e të aftësive profesionale, të cilat gjithashtu nuk janë konsideruar prej shumicës së trupit gjykues se përbëjnë në mënyrë autonome shkaqe për të konsideruar se plotësohen kërkesat e nenit 61 për secilin kriter (të përcaktuar në pikat 1-4 të kësaj dispozite), vlen për të potencuar konkluzionin se subjekti i rivlerësimit për shkak të një vlerësimi të përgjithshëm të të tria kriterëve ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe se asnjë program trajnues apo proces rehabilitimi nuk do të mund të shërbente për ta rikthyer këtë besim, prandaj ai duhet të shkarkohet nga detyra në zbatim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**GJYQTAR**

**SOKOL ÇOMO**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**INA RAMA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, jam dakord me vendimin e shumicës për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Izet Kadana, me arsyetimin lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për këtë subjekt rivlerësimi. Mendimi paralel i përket arsyetimit të rrethanave faktike dhe dispozitës që zbatohet në analizën e vlerësimit të figurës së këtij subjekti të rivlerësimit.
2. Në vlerësimin tim, në rrethanat faktike të shqyrtuara, përpos nenit 61, pika 3 dhe 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, gjejnë zbatim edhe dispozitat e nenit 61, pika 2. Analiza e fakteve kundrejt normave ligjore tregon që subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës pasi ka ruajtur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e detyrës (neni 61, pika 2). Asnjë nga rrethanat lehtësuese të parashkruara në nenin 38, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 nuk rezultojnë se ka vend të zbatohet në rastin konkret, siç është konstatuar gjatë hetimit.
3. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se takimet e tij me vëllanë R.K. kanë qenë të kufizuara, kryesisht në ceremonitë e vdekjes, apo për pasojë të problemeve shëndetësore të vetë të vëllait dhe të bashkëshortes së tij, e cila tanimë ka ndërruar jetë. Për sa i përket konstatimit nga ana e Komisionit se subjekti mund të vihet lehtësisht nën presion për shkak të veprave penale për të cilat është hetuar vëllai R.K. dhe nipat e tij, subjekti pretendon se ka ardhur në dijeni të procedimeve penale të nipave të tij vetëm gjatë hetimit administrativ dhe sjell në vëmendje se disa prej procedimeve nuk janë pjesë e veprave penale që përfshihen në krimin e organizuar.
4. Vlerësoj se konstatimi i Komisionit dhe referimi në nenin 39, pika 2 [e për pasojë edhe 61, pika 2] është i saktë dhe që subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit nuk arriti të zhbënte këtë konkluzion. Përkundrazi, subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor, duke zgjedhur një qëndrim të ri në ankim, për t'iu përshtatur situatës në të cilën gjendej dhe të argumentonte se qëndrimi i të birit, duke filluar nga viti 2016, të vëllezërit, ishte episodik. Konkretisht, gjatë hetimit administrativ subjekti u shpreh:

“[...] djali im rrin (qëndron nëse konsiderohet përdorim gjatë kohës që është në shkollë, në {\*\*\*} Tiranë) të vëllezërit e mi, me familjarët e tyre, R.K. dhe E.K. [...]. Për periudhën tjetër, djali im jeton në Pukë, aty ku ne jetojmë familjarisht, sipas adresës së dhënë në formularët përkatës [...]”<sup>77</sup>.

4.1. Në seancën publike, subjekti po ashtu konfirmoi këtë marrëdhënie të ngushtë të vazhdueshme mes tij dhe vëllezërve dhe familjarëve të tyre<sup>78</sup>. Në ankim, marrëdhënien e mësipërme të vazhdueshme me vëllezërit të cilët djali qëndron për gjithë vitin shkollor, subjekti zgjodhi ta përshkruante si të përbërë nga vizita të rralla, kryesisht në ndihmë të shoqërimit të bashkëshortes [ së ndjerë] të vëllait të mjeku.

<sup>77</sup> Faqja 3 e përgjigjeve të pyetësorit, dërguar Komisionit më 03.05.2018, përgjigje pyetjes nr. 5.

<sup>78</sup> Procesverbali i seancës publike dëgjimore, datë 18.12.2018.

4.2. Në analizë të sa më sipër, në dritën e parashikimeve të nenit 38, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në shpjegimet e tij subjekti rezulton të ketë pranuar se në marrëdhëniet e tij me vëllanë dhe familjen e tij, nuk gjente zbatim asnjë nga rrethanat lehtësuese të parashikuara nga ligji për vlerësimin e ekzistencës së një kontakti të papërshtatshëm në germa “a” deri në “dh”, pasi:

- i. germa “a” nuk zbatohet pasi vetë subjekti nuk e konteston dijeninë e përfshirjes së vëllait dhe nipit në procedime penale për vepra që lidhen me krimin e organizuar. [R dhe Sh.K., proceduar penalisht për pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale (neni 287 i Kodit Penal)];
- ii. germa “b” nuk gjen zbatim pasi marrëdhëniet e subjektit me vëllanë dhe nipat, sipas edhe shpjegimeve të tij, nuk mund të cilësohen si të rralla. Lënia e djalit të tij në kujdes familjeve të vëllezërve gjatë vitit shkollor mund të jetë gjithçka, por në asnjë kontekst nuk mund të përshkruhet si marrëdhënie e largët apo “kontakt i rrallë”;
- iii. germa “d” nuk zbatohet pasi qëndrimi i djalit rezulton të ketë filluar nga viti 2016;
- iv. germa “ç” dhe “dh” po ashtu nuk gjejnë zbatim<sup>79</sup>, pasi subjekti ka zgjedhur dhe ka pranuar qëndrimin e djalit në shtëpinë e vëllait, fakt që përjashton debatin mbi praninë e këtij të fundit; shpjegimet mbi rrethanat e gjendjes shëndetësore të rënduar të vëllait dhe të së shoqes nuk janë bindëse, pasi bien ndesh me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në hetim dhe në seancë.

5. Në vijim të sa më sipër, ndryshe nga shumica, vërej se me të drejtë Komisioni konstatoi që subjekti i rivlerësimit mund të vihet lehtësisht nën presion nga struktura kriminale, parashikuar nga neni 37, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 dhe që për shkak të procedimeve penale të katër nipave të tjerë, subjekti gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut, në vlerësim të të gjitha rrethanave. Nga dokumentacioni i administruar në fashikull, përfshirë informacionin e përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Shërbimit Informativ Kombëtar, rezulton që katër nipa të subjektit dhe njëri prej vëllezërve janë proceduar penalisht për vepra të ndryshme penale, përfshirë edhe vepra të cilat janë pjesë e veprave të krimit të organizuar, nga drejtësia shqiptare dhe të paktën njëri prej tyre edhe nga drejtësia italiane. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, për mungesë dijenie të përplasjeve me ligjin nga tre nipat e tjerë, përveç të ndjerit Sh.K., janë jobindëse, në konsideratë edhe të burimeve financiare të konsiderueshme të gjeneruara dhe të pajustificuara me burimet e deklaruara<sup>80</sup>, për të cilat hetimi nga autoritetet shqiptare ka zgjatur të paktën dy vjet, ashtu siç nuk është bindës pretendimi i tij se ka ruajtur marrëdhënie të rralla me vëllezërit dhe familjet e tyre, shtjelluar më sipër.

<sup>79</sup> Neni 38, pika 5, germa “ç” dhe “dh” parashikojnë respektivisht: “[...] ç) subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni që personi është i përfshirë në krimin e organizuar, por nuk ka qenë në dijeni të faktit se ai do të ishte i pranishëm në një takim, ose është mashtruar për një takim të tillë. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni [...] dh) çdo rrethanë tjetër lehtësuese, e cila parashtrrohet në mënyrë të besueshme nga subjekti i rivlerësimit [...]”.

<sup>80</sup> Shih faqen 9 të vendimit të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 28.02.2014, për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*}, datë 01.03.2012, për shkak të mungesës së përgjigjes nga autoritetet italiane të letërporosisë.

Në vlerësim të këtyre rrethanave, edhe nëse merret i mirëqenë pretendimi i subjektit se nipat e tij nuk mund të kenë pasur ndikim në punën e tij si gjyqtar, është e arsyeshme të deduktohet mungesë besimi te drejtësia nga këndvështrimi i një vëzhguesi të pavarur, në kontekstin në të cilin pesë (5) anëtarë të afërt të familjes së një gjyqtari — drejtues i një gjykate të një rrethi gjyqësor që i shërben një komuniteti relativisht të vogël — kanë përplasje me ligjin në mënyrë të përsëritur dhe për vepra penale të cilat duket të kenë prodhuar burime financiare të konsiderueshme.

## **GJYQTARE**

**REZARTA SCHUETZ**

*nënshkrimi*